

Unofficial translation

30Doc 12462

7 janar 2011

Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë¹

Raport²

Komiteti i Çështjeve Juridike dhe i të Drejtave të Njeriut

Raporter : Z. Dick MARTY, Zvicër, Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën.

Përmbledhje

Sipas informacioneve të mbledhura, tregues të shumtë konkretë dhe konvergues konfirmojnë se disa serbë, si dhe disa kosovarë shqiptarë janë mbajtur rob në vende të fshehta burgimi që ishin nën kontrollin e UÇK-së në veri të Shqipërisë, dhe u janë nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, për t'u zhdukur më pas përfundimisht. Tregues të shumtë me sa duket vërtetojnë se, në periudhën fill pas përfundimit të konfliktit të armatosur, përpara se forcat ndërkombëtare të merrnin në dorë kontrollin e rajonit dhe të vendosnin rendin e ligjshmërinë, organe të trupit u janë marrë disa robërve në një klinikë në territorin shqiptar, pranë Fushë-Krujës, për t'u transportuar më pas jashtë shtetit për qëllime transplantimi. Edhe pse disa prova konkrete ka pasur edhe më përpara për ekzistencën e trafikimeve të tilla qysh në fillim të dhjetëvjeçarit, autoritetet ndërkombëtare që ushtronin pushtetin në rajon nuk e panë të nevojshme që të bënin një shqyrtim të thelluar të këtyre rrethanave, apo e bënë atë në mënyrë jo të plotë e sipërfaqësore.

Organizatrat ndërkombëtare të vendosura në Kosovë u prirën drejt një qasjeje politike pragmatiste, duke menduar se duhej doemos favorizuar stabiliteti afatshkurtër, dhe duke sakrifikuar kështu disa parime të rëndësishme të drejtësisë. Ka qenë i pamjaftueshëm hetimi për lidhjen e anëtarëve të UÇK-së me krime lufte të kryera kundër popullsisë serbe dhe kosovarëve shqiptarë. Ekipi i prokurorëve dhe hetuesve ndërkombëtarë në gjirin e misionit të EULEX-it, ngarkuar për të ndjekur pretendimet për trajtime çnjerëzore, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me një trafikim të mundshëm organesh, ka bërë përparime, konkretisht ka provuar ekzistencën e vendeve të fshehta të burgimit të UÇK-së në veri të Shqipërisë, ku thuhet se janë kryer trajtime çnjerëzore, madje edhe vrasje.

Duhet goditur, pa kurrfarë kompromisi, mosndëshkimi i autorëve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Fakti që këto shkelje janë kryer në kuadrin e një konflikti të dhunshëm, nuk mund të përlijë kurrë heqjen dorë nga ndjekja penale e autorëve të akteve të tilla. Nuk mundet dhe nuk duhet të ekzistojë një drejtësi për fitimtarët dhe një tjetër drejtësi për të mundurit.

¹ Çdo referencë lidhur me Kosovën që përmendet në këtë tekst, qoftë për territorin, qoftë për institucionet apo popullsinë duhet kuptuar në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, pa paragjykuar statusin e Kosovës.

² I referohet Komitetit: Dok. 11574, Referencë 3446 e 29 majit 2008.

Shtetet anëtare të Bashkimit European dhe shtetet e tjera ndihmuese duhet t'i përcaktojnë EULEX-it një objektiv të qartë dhe t'i japin mbështetjen e nevojshme politike për të luftuar pa kompromis krimin e organizuar, me qëllim që drejtësia të vihet në vend, pa u prirë kurrsesi nga ndonjë përfitim politik. Shqipëria dhe administrata kosovare duhet të bashkëpunojnë pa rezervë për hetimet e sotme dhe ato në të ardhmen.

A. Projekt Rezolutë³

1. Asambleja Parlamentare u njoh me mjaft shqetësim me njoftimet e ish Kryeprokurores pranë Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (GJPNIJ), e cila pretendoi se gjatë konfliktit në Kosovë ishin kryer krime të rënda, përfshirë trafikim organesh njerëzore, krime që deri më sot kanë mbetur të pandëshkuara dhe nuk kanë qenë objekt i asnjë hetimi serioz.

2. Gjithnjë sipas ish Kryeprokurores, këto akte ishin kryer nga anëtarë të milicive të “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” (UÇK) ndaj shtetasve serbë mbetur në vend në fund të konfliktit të armatosur dhe të cilët ishin zënë robër.

3. Sipas informatave të mbledhura nga Asambleja dhe sipas hetimeve penale në proces, shumë tregues konkretë e konvergues konfirmojnë që disa serbë, si dhe disa kosovarë shqiptarë janë mbajtur robër në vende të fshehta burgimi të kontrolluara nga UÇK-së në veri të Shqipërisë dhe i janë nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, deri sa më në fund u zhdukën.

4. Tregues të shumtë duket që konfirmojnë se, në periudhën menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur, para se forcat ndërkombëtare të merrnin me të vërtetë në dorë kontrollin e rajonit dhe të vendosnin njëfarë rendi e ligjshmërie, robërve të zënë duhet t'u jenë marrë organet në një klinikë të ndodhur në territorin shqiptar, pranë Fushë-Krujës, për t'u transportuar më pas jashtë shtetit për qëllime transplantimi.

5. Ky aktivitet kriminal, që u zhvillua duke përfutur nga kaosi që sundonte në rajon dhe me nismën e disa drejtuesve të milicive të UÇK-së të lidhur me krimin e organizuar, ka vazhduar, ndonëse në forma të tjera, gjer në ditët tona, siç e vërteton një hetim që po kryen Misioni i Bashkimit European për Shtetin Juridik në Kosovë (EULEX) lidhur me klinikën “Medicus” në Prishtinë.

6. Megjithëse disa prova konkrete të trafikimeve të tilla ka pasur qysh në fillim të dhjetëvjeçarit, autoritetet ndërkombëtare që ushtronin pushtetin në rajon nuk e kanë parë të nevojshme të bënin një shqyrtim të thelluar të këtyre rrethanave, ose e bënë atë në mënyrë jo të plotë e sipërfaqësore.

7. Organizatave ndërkombëtare, ngarkuar me sigurinë dhe ligjshmërinë (KFOR-it e UNMIK-ut) u është dashur të përballen, sidomos gjatë viteve të para të pranisë së tyre në Kosovë, me probleme të mëdha strukturore dhe me mungesa serioze në personel të kualifikuar për të ushtruar detyrat e ngarkuara. Gjendja rëndohej më tej nga qarkullimi i shpejtë dhe i vazhdueshëm i kadrove në poste në Kosovë.

³ Projekt rezolutë e miratuar me unanimitet nga komiteti, më 16 dhjetor 2010.

8. GJPNIJ, që kish nisur të bënte një shqyrtim të parë në vend për të zbuluar praninë e gjurmëve të një trafiku të mundshëm organesh, i braktisi hetimet. Elementët e provës të zbuluara në Rripe të Shqipërisë janë shkatërruar dhe rrjedhimisht, nuk mund të shfrytëzohen për analiza të mëtejshme. Kështu, asnjë hetimi nuk i është shkuar më tej për një çështje të konsideruar megjithatë aq serioze sa ish Kryeprokurorja e GJPNIJ-së e pa të arsyeshme të bënte publike në librin e saj.

9. Gjatë fazës vendimtare të konfliktit të armatosur, NATO-ja ndërhyri me anë goditjesh ajrore, ndërkohë që operacionet tokësore drejtoheshin nga UÇK-ja, aleate faktike e forcave ndërkombëtare. Pas largimit të autoriteteve serbe, aktorët ndërkombëtarë të ngarkuar me sigurinë në Kosovë u mbështetën gjerësisht tek forcat politike në pushtet në Kosovë, të dala kryesisht nga kuadro të UÇK-së.

10. Organizatat ndërkombëtare të vendosura në Kosovë u prirën drejt një qasjeje politike pragmatiste, duke menduar se duhej doemos favorizuar stabiliteti afatshkurtër, dhe duke sakrifikuar kështu parime të rëndësishme të drejtësisë. Për një kohë të gjatë, pak u bë për t'u dhënë përgjigje sinjalizimeve që implikonin anëtarë të UÇK-së në krime kundër popullsisë serbe si dhe kundër Kosovarësh shqiptarë. Në fakt, menjëherë pas përfundimit të konfliktit, kur UÇK-ja kishte praktikisht e vetme kontrollin në terren, u kryen shumë larje hesapesh midis tarafesh të ndryshme dhe ndaj atyre që konsideroheshin, pa asnjë formë procesi gjyqësor, si tradhtarë, sepse dyshoheshin se kishin bashkëpunuar më parë me autoritetet serbe në vend.

11. EULEX, që në fund të vitit 2008 mori përsipër funksione në fushën e drejtësisë, të ushtruara më parë nga Kombet e Bashkuara (UNMIK), trashëgoi një gjendje të vështirë e delikate, sidomos në fushën e luftës kundër kriminalitetit të rëndë: dosje jo të plota, dokumente të humbura, dëshmi të pa mbledhura. Për rrjedhojë, shumë krime rrezikojnë të mbeten të pandëshkuara. Pak ose aspak kërkime të thelluara u bënë në fushën e kriminalitetit të organizuar dhe të lidhjeve të tij me përfaqësuesit e institucioneve politike, si dhe për krimet e luftës të kryera kundër serbëve e kosovarëve shqiptarë të konsideruar si bashkëpunëtorë apo si pjesëmarrës të fraksioneve kundërshtarë. Kjo çështje e fundit përbën një tabu të vërtetë sot e kësaj dite në Kosovë, edhe pse gojë më gojë e me shumë kujdes, të gjithë flasin për një gjë të tillë. EULEX ka bërë kohët e fundit, me sa duket, përparime në këtë drejtim, dhe duhen mbajtur të gjalla shpresat që vlerësimet politike të mos ndërhyjnë për të penguar këtë angazhim.

12. Ekipi i prokurorëve dhe hetuesve ndërkombëtarë në gjirin e misionit të EULEX-it, ngarkuar për të vërtetuar pretendimet lidhur me trajtimet çnjerëzore, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me një trafikim të mundshëm organesh, ka bërë përparime konkretisht për sa i përket provës së ekzistencës së vendeve të fshehta të burgimit të UÇK-së në veri të Shqipërisë ku thuhet se janë kryer trajtime çnjerëzore, madje edhe vrasje. Hetimi, megjithatë, nuk ka gjetur mbështetjen e duhur për bashkëpunim nga ana e autoriteteve shqiptare.

13. Emocioni që ngjallën në rrafsh botëror krimet e llahtarshme të bëra nga forcat serbe krijoi një atmosferë të tillë, që mund të vihej re edhe në qëndrimin e disa instancave ndërkombëtare, duke u mbështetur në mendësinë se disa konsideroheshin doemos si xhelatë, dhe të tjerët si viktima, pra pashmangshmërisht të pafajshëm. Realiteti është më i nuancuar e kompleks.

14. Asambleja ripohon me forcë domosdoshmërinë për të luftuar, pa asnjë kompromis, mosndëshkimin e autorëve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, dhe rikujton se fakti

që këto shkelje janë kryer në kuadrin e një konflikti të dhunshëm, nuk mund të përligjë kurrsesi heqjen dorë nga ndjekja penale e autorëve të akteve të tilla (shih Rezolutën 1675 (2009)).

15. Nuk mund dhe nuk duhet të ekzistojë një drejtësi për fituesit dhe një tjetër drejtësi për të mundurit. Në çdo konflikt, tërë kriminelët duhet të ndiqen penalisht dhe të cilësohen përgjegjës për aktet e tyre të paligjshme, cilido qoftë kampi të cilit i përkasin dhe pavarësisht nga roli politik që kryejnë.

16. Çështja më e mprehtë dhe më delikate, nga pikëpamja humanitare, është ajo që ka të bëjë me personat e zhdukur. Nga mbi 6 000 dosjet e personave të zhdukur të çelura nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, rreth 1 400 persona janë gjetur të gjallë dhe 2 500 kufoma janë arritur të zbulohen e të identifikohen. Është fjala në shumicën e tyre për viktime kosovare shqiptare të gjetura në varret masive të zbuluara në rajonet që janë nën kontroll serb dhe në Kosovë.

17. Bashkëpunimi midis instancave ndërkombëtare nga njëra anë, dhe autoriteteve kosovare e shqiptare nga ana tjetër, për të zbardhur fatin e personave të zhdukur është ende më se i pamjaftueshëm. Ndërsa Serbia më në fund arriti të bashkëpunojë, realizimi i gërmimeve në territorin e Kosovës u shfaq shumë më i komplikuar, kurse në territorin shqiptar ka qenë i pamundur, të paktën gjer më sot,. Bashkëpunimi me autoritetet kosovare lë për të dëshiruar sidomos për sa u përket kërkimeve për rreth 500 persona zyrtarisht të zhdukur pas përfundimit të konfliktit.

18. Grupi i punës për personat e zhdukur, i bashkë-kryesuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe Zyra për Personat e Zhdukur të EULEX-it, ka nevojë për përkrahje të plotë e të gjithanshme të bashkësisë ndërkombëtare, me qëllim që të tejkalohen ngurrimet e shfaqura nga çdo anë. Njohja e së vërtetës dhe krijimi i mundësisë që më në fund familjet e viktimave të mbajnë zi është kusht i domosdoshëm për pajtim midis bashkësive dhe për paqe të qëndrueshme në këtë rajon të Ballkanit.

19. Asambleja fton me këtë rast:

19.1. shtetet anëtare të Bashkimit European dhe shtetet e tjera ndihmëse:

19.1.1. të pajisin EULEX-in me burimet e nevojshme, logjistike e me personel tepër të kualifikuar për t'i bërë ballë misionit jashtëzakonisht kompleks e të rëndësishëm që i është besuar;

19.1.2. t'i caktojnë objektiv të qartë EULEX-it si dhe t'i japin përkrahje politike të shkallës më të lartë për të luftuar pa kompromis kriminelin e organizuar dhe për të vënë në vend drejtësinë, pa kurrfarë arsytimi për përshtatshmëri politike;

19.1.3. të angazhojnë tërë mjetet e nevojshme për të hartuar programe të efektshme lidhur me marrjen në mbrojtje të dëshmitarëve;

19.2. EULEX-in:

19.2.1. të vazhdojë me këmbëngulje punën e tij hetimore, pa marrë aspak parasysh funksionet e ushtruara nga të dyshuar të mundshëm, apo origjinën e

viktimave, duke vënë gjithçka në zbatim për të hedhur dritë mbi zhdukjet kriminale, mbi treguesit e trafikut të organeve, mbi korrupsionin dhe bashkëpunimin midis qarqeve mafioze e politike, aq shpesh të denoncuara;

19.2.2. të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtje të efektshme për dëshmitarët dhe të fitojë besimin e tyre;

19.3. GJPNIJ-në, të bashkëpunojë plotësisht me EULEX-in, konkretisht duke vënë në dispozicion të tij të dhënat dhe elementët e provës që disponon dhe që mund të ndihmojnë EULEX-in për të ndjekur penalisht përgjegjësit e krimeve në bazë të kompetencës që ka;

19.4. autoritetet e Serbisë:

19.4.1. të bëjnë të gjitha përpjekjet për të kapur personat ende në kërkim nga GJPNIJ për krime lufte, konkretisht gjeneralin Ratko Mlladiç e Goran Hadziç, mosdëshkimi i të cilëve vazhdon të jetë pengesë serioze për procesin e pajtimit dhe që përmendet shpesh nga autoritetet e vendeve të tjera për të përligjur angazhimin e tyre të paktë në ndërmarrjen nga ana e tyre të veprimeve gjyqësore;

19.4.2. të bashkëpunojnë ngushtë me EULEX-in, konkretisht duke i dhënë tërë informatat që mund të ndihmojnë në zbardhjen e krimeve të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë;

19.4.3. të marrin të gjitha masat e nevojshme për të penguar rrjedhje të informatave në shtyp lidhur me hetimet që kanë të bëjnë me Kosovën, gjë që dëmton bashkëpunimin me autoritetet e tjera dhe besueshmërinë e punës hetimore.

19.5. autoritetet e Shqipërisë dhe administratën kosovare:

19.5.1. të bashkëpunojnë pa rezerva me EULEX-in dhe me autoritetet serbe në kuadrin e procedurave për të hedhur dritë mbi krimet e bëra në Kosovë, pavarësisht nga origjina e njohur apo e hamendësuar e të dyshuarve dhe e viktimave;

19.5.2. t'u përgjigjen, në mënyrë të veçantë, kërkesave për ndihmë juridike të EULEX-it lidhur me fakte të natyrës kriminale që pretendohet të kenë ndodhur në një kamp të UÇK-së në veri të Shqipërisë;

19.5.3. të ndërmarrin hetim serioz e të pavarur për të hedhur dritë plotësisht mbi pretendimet ngandonjëherë konkrete e të sakta lidhur me ekzistencën e qendrave të fshehta të burgimit ku pretendohet të jenë kryer trajtime çnjerëzore ndaj robërve të ardhur nga Kosova, me origjinë sa serbe aq edhe shqiptare, gjatë dhe menjëherë pas konfliktit; hetimi duhet të shtrihet gjithashtu në verifikimin e pretendimeve, po aq specifike, lidhur me trafikim organesh që thuhet të ketë ndodhur gjatë së njëjtës periudhë, pjesërisht mbi territorin shqiptar;

19.6. të gjitha shtetete interesuara anëtare dhe vëzhguese të Këshillit të Europës:

19.6.1. t'u përgjigjen brenda afateve më të shkurtra kërkesave për bashkëpunim juridik që u ka drejtuar EULEX-i dhe autoritetet serbe në kuadrin e hetimeve të tyre në proces lidhur me krimet e luftës dhe trafikun e organeve; vonesa për këto përgjigje është e pakuptueshme dhe e papranueshme po të mbahet parasysh rëndësia dhe urgjenca e bashkëpunimit ndërkombëtar për t'u bërë ballë dukurive kriminale aq të rënda e të rrezikshme;

19.6.2. të bashkëpunojnë me EULEX-in në përpjekjet e tij për mbrojtjen e dëshmitarëve, konkretisht kur këta nuk mund të jetojnë më në rajon, e rrjedhimisht, duhet të marrin një identitet të ri e të gjejnë një vend të ri qëndrimi.

20. Asambleja, e ndërgjegjshme se trafikimi i organeve njerëzore përbën tashmë një dukuri me përmasë botërore dhe jashtëzakonisht serioze, që bie ndesh hapur me normat më themelore të të drejtave dhe të dinjitetit të personit, përshëndet dhe mbështet konkluzionet e studimit të bashkëngjitur botuar më 2009 dhe realizuar nga Këshilli i Europës dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara. Mbështet po ashtu konkluzionin sipas të cilit është e nevojshme të përpunohet një instrument juridik ndërkombëtar që do bëjë të mundur të përkufizohet trafikimi i organeve, indeve e qelizave me origjinë njerëzore, të përcaktohen masat që duhen marrë për të parandaluar këtë trafikim e për të mbrojtur viktimat, si dhe masat e së drejtës penale për shtypjen e këtij trafikimi.

B. Raport shpjegues, nga M. Marty, reporter

Përmbledhje

Faqe

1. Vlerësime paraprake - vështrim tërësor	
2. Koment fillestar rreth burimeve.....	
3. Rezultatet e hollësishme të hulumtimeve tona.....	
3.1. Një vështrim tërësor	
3.2. Tarafizimi i UÇK-së dhe lidhjet me krimin e organizuar.....	
3.3. Vendet e burgimit dhe trajtimi çnjerëzor i robërve.....	
3.3.1. Burgime nga UÇK në kohë lufte – Kategoria e parë e robërve: “robërit e luftës”	
3.3.1.1. Karakteri i qendrave të burgimit: Cahan.....	
3.3.1.2. Karakteri i qendrave të burgimit: Kukës.....	
3.3.2. Burgime nga anëtarë dhe simpatizantë të UÇK-së pas përfundimit të konfliktit.....	
3.3.2.1. Kategoria e dytë e robërve: “të zhdukurit”	
3.3.2.1.1. Karakteri i qendrave të burgimit: Rripe.....	
3.3.2.1.2. Hetime rreth kushteve të burgimit dhe transportit.....	
3.3.2.2. Kategoria e tretë e robërve: “viktimat e kriminaliteti të organizuar”	
3.3.2.2.1. Karakteri i qendrave të burgimit: Fushë-Krujë.....	
4. Klinika Medicus.....	
5. Tavanizimi i padukshëm i detyrimit për llogaridhënie.....	
6. Disa mendime përfunduese.....	
7. Shtojcë: Harta.....	

1. Vlerësime paraprake - vështrim tërësor

1. Në prill 2008, ish Kryeprokuroja pranë Gjykatës penale ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (GJPNIJ), Znj. Carla del Ponte, botoi një libër dëshmi, në bashkëpunim me Chuck Sudetic, lidhur me përvojën e saj si magjistre në gjirin e këtij institucioni. Libri u botua në fillim në italisht (“*La caccia – Io e i criminali di guerra*”), pastaj u përkthye, konkretisht në frëngjisht (“*Gjuetia – Unë dhe kriminelët e luftës*”). Në këtë libër, gati dhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, flitet për një trafikim organesh njerëzore që u janë marrë robërve serbë, trafikim i cili, siç thuhet në libër, ishte i organizuar nga drejtues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Këto pretendime ishin tronditëse dhe ngjallën reagime të ashpra. Ishin tronditëse, fillimisht, sepse dilnin nga një person që kishte punuar në postet më të larta në zemër të sistemit gjyqësor të ngarkuar për ndjekjen penale të krimeve të bëra gjatë konfliktit që rrënoi ish Jugosllavinë. Ishin gjithashtu, por mbi të gjitha, tronditëse sepse ato nxorën në pah mungesën me sa duket, të një praktike apo reagimi zyrtar, lidhur me këto pretendime, të gjykuara megjithatë aq serioze, sa u rishfaqën në kujtimet e ish kryeprokurores, e cila nuk mund të linte mënjanë rëndësinë dhe peshën e akuzave që ajo vendosi t’i bëjë publike.

2. Mbi bazën e një propozim rezolute (Dok. 11574), në të cilin kërkohet të bëhet një hetim i thelluar lidhur me veprimet e përmendura nga Znj. Carla del Ponte dhe pasojat e tyre, me qëllim që të verifikohet nëse ishin të vërteta, që të vendosej drejtësia për viktimat dhe të kapeshin autorët e krimeve, Komisioni i Çështjeve Juridike dhe i të Drejtave të Njeriut më emëroi raporter, duke më ngarkuar kështu hartimin e raportit.

3. Mandati që m'u besua u ndesh menjëherë me vështirësi të jashtëzakonshme Faktet e pretenduara – të mos harrojmë se paaqiteshin nga një ish magjistre e rangut ndërkombëtar, – kishin ndodhur para gati dhjetë vjetësh dhe nuk patën qenë objekt i një hetimi të vërtetë prej asnjë nga autoritetet kombëtare e ndërkombëtare që vepronin në territoret përkatëse. Gjithçka me sa duket tregon se përpjekjet për të nxjerrë në dukje faktet dhe për të ndëshkuar krimet e luftës ishin përqendruar sidomos në një drejtim, duke u mbështetur në prezumimin e nënkuptuar se njëra palë ishte viktimat, dhe pala tjetër, xhelatët. Realiteti, siç do ta shohim, duket se ka qenë më kompleks. Struktura ende tepër klanore e shoqërisë kosovare shqiptare, si dhe mungesa e një shoqërie të vërtetë civile e bënë jashtëzakonisht të vështirë vendosjen e kontakteve me burimet lokale. Shtojmë këtu edhe frikën, shpesh një tmerr i vërtetë, që vumë re tek disa nga bashkëbiseduesit tanë sapo preknim temën e kërkimeve tona. Madje edhe disa përfaqësues të autoriteteve ndërkombëtare nuk e fshihnin mungesën e gatishmërisë për t'u marrë me këto fakte: “E shkuara është e shkuar, tani duhet të shohim përpara”, na thanë. Sa për autoritetet shqiptare, ato bënë të ditur se territori i tyre ka qenë jashtë konfliktit dhe nuk kishin asnjë arsye për fillimin e një hetimi. Autoritetet serbe reagues, ndonëse mjaft me vonesë, pa arritur megjithatë ndonjë rezultat domethënës. Nga ana e saj, GJPNIJ kishte bërë disa kërkime eksploruese lidhur me të famshmen “Shtëpi e verdhë”, duke vepruar megjithatë në një mënyrë mjaft sipërfaqësore dhe me një shkallë profesionalizmi që ngjall njëfarë habie. Kësaj i shtohet edhe fakti që mandati i GJPNIJ-së ishte i kufizuar brenda një hapësire dhe periudhe kohore mjaft të përcaktuara: GJPNIJ kishte kompetencë për ndjekje e gjykim të krimeve të kryera deri në qershor 1999, që përbënte fundin e konfliktit në Kosovë, dhe kompetenca e saj nuk shtrihet në Shqipëri, përveç rastit nëse Shqipëria vetë do të autorizonte shprehimisht veprime hetimi në territorin e saj.

4. Veprimet me të cilat po merremi sot, pretendohet të kenë ndodhur sidomos duke filluar nga vera e vitit 1999, në gjendjen e pështjellimit të madh që mbretëronte në krejt rajonin: forcat serbe të sigurimit kishin braktisur Kosovën dhe trupat e KFOR-it (Forcës ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë që ishte në kuadrin e NATO-s) kishin filluar të vendoseshin ngadalë, ndërkohë që qindra mijëra refugjatë kosovarë shqiptarë në fillim u përpoqën të arrinin në Shqipëri, dhe më pas të ktheheshin në vatrat e tyre, ndërsa serbët nga ana e tyre po strehoheshin në territoret nën kontroll të ushtrisë serbe. Ishte kaos: administrata kosovare nuk funksiononte, KFOR-it iu desh njëfarë kohe për të marrë në dorë kontrollin e gjendjes, pa pasur aftësinë e nevojshme për të përballur situata aq të jashtëzakonshme. Ndërhyrja e NATO-s u bë kryesisht nëpërmjet një fushate me bombardime ajrore në Kosovë e në Serbi – operacione që u konsideruan prej disa burimeve se binin ndesh me të drejtën ndërkombëtare, duke qenë se Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara nuk kishte dhënë autorizimin e tij – ndërsa në terren, aleati faktik i NATO-s ishte UÇK-ja. Kësisoj, në periudhën kritike që sapo përshkruam, kjo e fundit kishte kontrollin faktik mbi një territor të gjerë që përfshinte Kosovën dhe rajonet kufitare të Shqipërisë veriore. Sigurisht, nuk bëhet fjalë për një pushtet me të vërtetë të strukturuar dhe as që bëhet fjalë se mund të kishte konturet e një shteti, përkundrazi. Pikërisht gjatë kësaj periudhe u kryen krime të shumta, si ndaj serbëve të mbetur në rajon, ashtu dhe ndaj kosovarëve shqiptarë të dyshuar se kishin qenë “tradhtarë” apo “bashkëpunëtorë”, apo që kishin qenë viktimat të rivaliteteve midis fraksioneve të UÇK-së. Këto krime kanë mbetur në shumicën e tyre të pandëshkuara dhe

vetëm pas vitesh të tëra po fillohet, në mënyrë mjaft të ndrojtur, angazhimi për t'u marrë me to.

5. Gjatë kësaj faze kaotike, kufiri midis Kosovës e Shqipërisë nuk ekzistonte më. Nuk ekzistonte asnjë formë kontrolli, gjë që, nga ana tjetër, nuk do mund të ishte kurrsesi i realizueshëm po të mbahet parasysh fluksi i madh i refugjatëve drejt Shqipërisë dhe kthimi i tyre në të njëjtat përmasa pas mbarimit të veprimeve luftarake. Gjatë një misioni në terren për llogari të Parlamentit tim, më 1999, unë vetë personalisht konstatova përmasën e gjerë të dukurisë; sidomos vura re solidaritetin e shquar të shfaqur nga popullsia dhe autoritetet shqiptare në pritjen e refugjatëve kosovarë. Pikërisht në këto rrethana milicët e UÇK-së zhvendoseshin lirisht në të dy anët e kufirit, i cili, sikurse e theksuam, ishte shndërruar tanimë në një vijë ndarëse krejt virtuale. Pra, ishte vetëm UÇK-ja ajo që ushtronte gjatë kësaj periudhe kritike kontrollin faktik në rajon, si në Kosovë ashtu dhe në pjesën veriore të Shqipërisë pranë kufirit. Dhe me këta zotër të vendit bashkëpunuan forcat ndërkombëtare në kuadrin e operacioneve ushtarake dhe të rivendosjes së rendit. Kjo situatë solli gjithashtu si pasojë që faktikisht të mbulohen e të mbeten të pandëshkuara krime të kryera nga anëtarë të UÇK-së, përfshirë edhe drejtues të lartë.

6. Krimet e kryera nga trupat serbe u dokumentuan, u denoncuan dhe, për aq sa ishte e mundur, edhe u gjykan. Bëhet fjalë për krime, karakteri i llahtarshëm i të cilave nuk ka nevojë të përshkruhet më tej. Ato ishin rezultat i një politike të kobshme të urdhëruar nga Millosheviçi dhe të zbatuar gjatë një periudhe të gjatë, përfshirë edhe kohën kur ky pritej me të gjitha nderimet në shumë kryeqytete të shteteve demokratike. Këto krime shkaktuan dhjetëra mijëra viktima dhe tronditën krejt një rajon të kontinentit tonë. Gjatë konfliktit të Kosovës, popullsia me origjinë shqiptare pësoi dhunime të egra, pasoja të një politike të marrë spastrimi etnik nga ana e diktatorit të atëhershëm në krye të Beogradit. E gjithë kjo nuk ka se si të vihet në dyshim në kohën e sotme. Megjithatë, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se në atë kohë u zhvilluan një klimë dhe një dinamikë e tillë që bënë të mundur të trajtohen tërë ngjarjet dhe faktet në një optikë dualiste: nga njëra anë serbët, domosdoshmërisht shtypës të këqij, dhe nga ana tjetër kosovarët shqiptarë, pashmangshmërisht viktima të pafajshme. Në tmerrin dhe në kryerjen e krimeve nuk mund të ketë parim të kompensimit. Ndjenja elementare e drejtësisë kërkon që të gjithë të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Detyrimi për të gjetur të vërtetën dhe për të dhënë drejtësinë është nga ana tjetër një premisë e domosdoshme që një paqe e vërtetë të rivendoset dhe që bashkësitë e ndryshme të arrijnë të pajtohen e të fillojnë të jetojnë e punojnë së bashku.

7. Mirëpo në rastin e Kosovës, duket se mori përparësi logjika e çastit: të rivendoset sa më shpejt rendi, duke shmangur gjithçka që mund të destabilizojë rajonin, i cili vazhdon të jetë në gjendje ekuilibri mjaft të brishtë. E gjithë kjo solli vendosjen e një drejtësie që mund të cilësohet si selektive, pasojë e së cilës ka qenë dhe vazhdon të jetë mosndëshkimi i krimeve të shumta, ku tërë shenjat e besueshme tregojnë se ato kanë qenë vepër, e drejtpërdrejtë a e tërthortë, e drejtuesve të lartë të UÇK-së. Vendet perëndimore që u angazhuan në Kosovë iu shmangën ndërhyrjes së drejtpërdrejtë në terren, duke parapëlqyer përdorimin e goditjeve ajrore. UÇK-ja u bë në këtë mënyrë aleati i tyre i domosdoshëm për veprimet tokësore. U parapëlqye kështu të mbylleshin sytë ndaj krimeve të luftës të bëra nga kjo e fundit, duke favorizuar njëfarë stabiliteti afatshkurtër. Në fakt, Kosova e re u ndërtua kryesisht mbi strukturat ekzistuese të lëvizjes atdhetare (homeland) kosovare shqiptare. Administratat ndërkombëtare që pasuan njëra tjetrën në vend, si dhe administrata amerikane që, sipas mendimit të përgjithshëm luan një rol të madh në mbarëvajtjen e çështjeve të entitetit të ri

Kosovë⁴, u bënë pra njësh me aleatët e tyre faktikë në terren, të cilët ishin bërë tashmë zotëruesit e rinj të politikës lokale. Kjo gjendje, sikurse e theksuam, pengoi në fund të fundit që të hidhet plotësisht dritë mbi krimet e kryera, kur gjithçka tregonte se ato ishin vepër e personave që ishin në pushtet apo të afërt me ta. Kësaj i shtohet fakti që administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut (Misionit administrativ të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë) kishte në dispozicion të vet, në mënyrë sasiore e cilësore, mjete të pamjaftueshme për të ndjekur penalisht krimet e kryera në mënyrë të efektshme dhe të paanshme. Personeli ndërkombëtar i caktuar në vend në kuadër të UNMIK-ut, rekrutohej në pjesën më të madhe mbi bazë kontratash për periudhë të kufizuar, gjë që shkaktonte rotacion të vazhdueshëm dhe përbënte në këtë mënyrë një pengesë madhore në administrimin e drejtësisë. Drejtues të administratës ndërkombëtare na kanë vënë në dijeni të pamundësisë për kryerje të hetimeve në mënyrë të fshehtë – gjë që është kusht themelor për përfundimin me sukses të një hetimi kriminal – dhe kjo, konkretisht për shkak të përdorimit të përkthyesve vendas që ua përcillnin informatat të interesuarve. Për hetime më delikate EULEX-it iu desh më pas të përdorte përkthyes të ardhur nga vende të tjera. Po këto burime na thanë se gjithë filozofia e bashkësisë ndërkombëtare mund të përmbledhet në parimin “stabilitet e paqe me çdo kusht”, gjë që do të thoshte sigurisht të mos prisheshe me pushtetin në vend.

8. Misioni i EULEX-it (Misioni europian i policisë dhe drejtësisë në Kosovë), i vendosur që prej fundit të vitit 2008, trashëgoi në këtë mënyrë një gjendje tejet të vështirë. Shumë dosje krimesh lufte, konkretisht ato për të cilat dyshohen luftëtarë të UÇK-së, u rimorën nga UNMIK-u në gjendje të mjerueshme (prova dhe dëshmi të humbura, kohë mjaft e gjatë ndërmjet veprimeve kërkuese të paplota), deri në atë pikë sa drejtues të EULEX-it nuk i përtypnin fjalët gjatë vizitave tona informuese dhe shprehën frikën që shumë dosje duhej të braktiseshin⁵. Disa bashkëbisedues që përfaqësojnë shoqërinë civile kosovare në lindje e sipër nuk i kursyen kritikën e tyre po ashtu kundër EULEX-it: pritej që EULEX-i të godiste më në fund edhe “të paprekshmit”, e shkuara e të cilëve njihet nga të gjithë si nga më të turbulltat. Më kot: pati shumë lajmërimë, shumë premtime, por rezultatet konkrete veç rrinë e presin. Çështja e Nazmi Bllacës, “dhënësit të alarmit”, që publikisht u vet-akuzua për vrasje të komanduara nga persona që sot janë të veshur me përgjegjësi të larta politike, është emblematike. U pritën katër ditë para se të arrestohej e të vendosej nën mbrojtje. Mënyra se si EULEX-i do ta trajtojë këtë çështje përbën një testim të rëndësishëm të vendosmërisë së tij për t’i shkuar gjer në fund misionit të vet të drejtësisë.

9. Megjithatë, duhet përsëritur angazhimi i shquar i shumë veprimtarëve të EULEX-it – sot rreth 1 600 kuadro ndërkombëtarë dhe 1 100 nëpunës lokalë – si dhe vendosmëria e tyre për të përballur sfidën e jashtëzakontë që u është besuar. Përpjekjet po fillojnë të japin rezultate të dukshme, konkretisht për sa i përket dosjeve të kampit të Kukësit dhe të klinikës Medicus në Prishtinë. EULEX-i duhet doemos të gëzojë një përkrahje më të qartë e më të vendosur në rrafshin më të lartë politik europian. Asnjë dykuptimësi nuk duhet të ekzistojë lidhur me domosdoshmërinë për të goditur të gjithë të dyshuarit e krimin, qoftë edhe kur mbajnë poste të larta institucionale e politike. Është po ashtu urgjente t’i jepen EULEX-it e drejta e futjes në tërë arkivat e instancave ndërkombëtare që kanë qenë më parë të pranishme në Kosovë,

⁴ Shtetet e Bashkuara kanë një ambasadë që disponon mjete nga më të fuqishmet, si dhe një bazë ushtarake, Camp Bondsteel, rëndësia e së cilës shkon shumë më përtej përmasës krahinore.

⁵ “Trashëgimia e UNMIK-ut” na u përshkrua në një mënyrë shumë figurative, që nuk ka nevojë për koment : “300 000 faqe rrëmujazi”.

përfshirë edhe ato të KFOR-it, të atdhesuara ndërkohë në vendet pjesëmarrëse⁶, si dhe dosjet e GJPNIJ⁷. Sipas praktikantëve që punojnë në vend, lypset të krijohet një bazë të dhënash e unifikuar dhe e përbashkët e arkivave të krejt aktorëve ndërkombëtarë, e hapur dhe pa pengesa për hetuesit e EULEX-it. Kemi të drejtë të pyesim se cilat mund të jenë arsyet që pengojnë zbatimin e një kërkesë të tillë kaq themeltare.

10. Policia kosovare, me karakter ndëretnik, është e formuar nga ana profesionale, e pajisur më së miri dhe e efektshme në luftën kundër kriminalitetit të vogël e të mesëm. E përbërë nga mbi 7 200 policë me uniformë dhe mbi 1 100 ndihmës, ajo ka në gjirin e vet përfaqësues nga 13 grupet etnike, përfshirë 10 % Serbë. Sipas sondazheve të fundit, me sa duket, ajo gëzon besimin më të madh nga ana e të gjitha institucioneve në Kosovë, pas KFOR-it. Drejtues të lartë ndërkombëtarë na pohuan se “policia është e mirë”, por gjykatësit “përbëjnë problem” – duke qenë objekt goditjeje me anë të frikësimit, nën ndikimin politik apo korruptues. Megjithatë, edhe gjykimet ndaj policisë janë të nuancuara në radhët e vëzhguesve që takuam. Ky institucion duhet të vazhdojë të japë provat e veta dhe të fitojë krejt besimin e partnerëve ndërkombëtarë, përfshirë edhe ata të misionit të EULEX-it, ku ne ndiem ende disa dyshime lidhur me vullnetin politik të masës së drejtuesve të kësaj force të policisë për të luftuar pa rezerva kundër të gjitha formave të kriminalitetit, e në mënyrë të veçantë kundër krimit të organizuar, krimeve që implikojnë personalitete të larta politike, si dhe konkretisht, lidhur me vullnetin dhe aftësinë për të siguruar një mbrojtje me të vërtetë të efektshme të dëshmitarëve, aspekt shumë delikat e i domosdoshëm për ndjekjen penale të kriminelëve më të njohur e të rrezikshëm.

11. Korrupsioni dhe kriminaliteti i organizuar përbëjnë problem madhor në rajon, siç e tregojnë shumë studime ndërkombëtare. Dukuria bëhet edhe më e rëndë po të mbahen parasysh lidhjet ekzistuese midis kriminalitetit, korrupsionit dhe politikës. Prania masive e veprimtarëve ndërkombëtarë nuk i lehtëson gjërat dhe çon në rezultate perverse: një shofer apo një pastruese në një institucion ndërkombëtar a në një ambasadë fiton, si rregull i përgjithshëm, shumë më tepër se një polic a një gjykatës. Kjo nuk bën gjë tjetër veçse cenon shkallën e vlerave.

12. Dosja më urgjente nga pikëpamja humanitare është ajo e personave të zhdukur në kuadrin e konfliktit të Kosovës. Numri i zhdukjeve është shumë i madh në raport me popullsinë e përgjithshme të Kosovës. Nga 6 005 dosje zhdukjesh të çelura nga Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, rreth 1 400 persona u rigjetën të gjallë dhe 2 500 trupa u arritën të zbulohen e të identifikohen. Bëhet fjalë në shumicën e tyre për viktime kosovare me përkatësi shqiptare të rigjetura, gjysmë përgjysmë, përkatësisht në varre masive zbuluar në territor nën kontroll efektiv serb, dhe në Kosovë. Shifrës prej 1 869 vetë të zhdukur gjatë konfliktit, fati i të cilëve ende nuk dihet (nga të cilët rreth dy të tretat janë Kosovarë me përkatësi shqiptare), i shtohen 470 personat e zhdukur pas mbërritjes së trupave të KFOR-it më 12 qershor 1999, prej të cilëve 95 janë të përkatësisë shqiptare dhe 375 jo-shqiptarë, në shumicën serbë⁸.

⁶ Mësuam se disa pjesëmarrës të KFOR-it (për shembull Mbretëria e Bashkuar) morën me vete krejt arkivat: këto janë të hapura për hetuesit e EULEX-it vetëm mbi bazën e kërkesave individuale të motivuara, një procedurë komplekse që e ngadalëson së tepërmi punën e drejtësisë.

⁷ Në kohën e vizitës sonë në janar 2010, EULEX-i vazhdonte të mos kish të drejtë futjeje në dosjet e GJPNIJ-së, por prokurori i GJPNIJ, me sa duket, e paska siguruar EULEX-in se së shpejti do t'i jepet kjo e drejtë.

⁸ Janë shifra të OMPF (*Office for Missing Persons and Forensics – Zyra e personave të zhdukur dhe e mjekësisë ligjore*) lidhur me rastet ende të pasqaruara të fillimit të vitit 2010).

13. Lidhur me këto zhdukje, duhet theksuar se shumë familje kosovare shqiptare që kanë humbur një të afërt të tyre pas 12 qershorit 1999, do kenë shpallur një datë zhdukjeje përpara kësaj date, nga frika se mos të afërmit e tyre cilësohen si “tradhtarë” të ndëshkuar nga UÇK-ja. Është domethënës fakti që ligji kosovar mbi dëmshpërblimin e familjeve të “dëshmorëve” përjashton shprehimisht personat e vdekur pas mbërritjes së KFOR-it. Për sa i përket ligjit, ende në diskutim, mbi dëmshpërblimin e familjeve të personave të zhdukur, qëndrimi i autoriteteve kosovare është që të mbulohen vetëm zhdukjet që kanë ndodhur midis 1 janarit 1999 dhe 12 qershorit 1999. Në fakt, kjo tregon se deri në ç’pikë ky problem i të zhdukurve kosovarë shqiptarë është ende i ndjeshëm. Sipas një pjese të mirë të bashkëbiseduesve tanë, çështja mbetet një tabu e vërtetë dhe vazhdon të jetë një pengesë serioze për kërkimin e së vërtetës, sepse gjuetia ndaj “tradhtarëve” shpesh ka fshehur luftën e përgjakshme midis grupazheve të UÇK-së dhe ka shërbyer për fshehjen e krimeve të bëra nga anëtarë të UÇK-së apo persona të lidhur me të.

14. Zyra e personave të zhdukur dhe e mjekësisë ligjore⁹ ka hasur në vështirësi të mëdha për të punuar me dokumentacionin, shpesh i një cilësie të keqe, trashëguar nga paraardhësit¹⁰; ka po ashtu vështirësi për të motivuar e mbajtur personelin e vet, që paguhet keq në raport me kualifikimet e kërkuara. Bashkëpunimi midis instancave të ndryshme ndërkombëtare dhe autoriteteve kosovare, si dhe i autoriteteve kompetente të Shqipërisë për të zbardhur fatin e personave të zhdukur lë për të dëshiruar. Ndërsa Serbia ka bashkëpunuar, jo pa ngurrime fillimisht nga ana e saj, në operacionet e kërkimit të varreve masive të dyshuara në territorin që ndodhet nën kontrollin e saj, veprime të tilla kërkuese u shfaqën shumë më të komplikuar në territorin e Kosovës¹¹, madje të pamundura gjer tani në territorin shqiptar¹². Bashkëpunimi me autoritetet kosovare është i mangët në mënyrë të veçantë për sa i përket 470 zhdukjeve zyrtarisht të ndodhura pas përfundimit të konfliktit¹³. Mungesa e bashkëpunimit me autoritetet kosovare e shqiptare për kërkimin e personave të zhdukur serbë, madje edhe kosovarë shqiptarë që mund të shfaqen si viktima të krimeve të kryera nga anëtarë të UÇK-së, ngjall dyshime serioze për sa i përket vullnetit politik të autoriteteve të sotme për të nxjerrë në dritë krejt të vërtetën lidhur me këto ngjarje.

15. Grupi i punës për personat e zhdukur, i kryesuar nga Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, ka nevojë për mbështetje të plotë e të gjithanshme nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për të dalë mbi ngurrimet që vihen re nga çdo palë qoftë, në interes të njerëzve të afërt të viktimave, vuajtjet e vazhdueshme të të cilëve përbëjnë një pengesë të madhe për procesin e pajtimit.

⁹ OMPF, aktualisht e bashkëdrejtuar nga një përfaqësues i EULEX-it dhe një përfaqësues i autoriteteve kosovare, me sa duket është krijuar, siç na thanë, “për të zhdukur kaosin e trashëguar nga UNMIK dhe GJPNJ”.

¹⁰ Sidomos kur bëhet fjalë për raste që kanë të bëjnë me “periudhën e kaosit” nga qershori në fund të tetorit 1999; ushtarët e KFOR-it nuk ishin të kualifikuar për punë policie dhe raportet e tyre lidhur me vendet e krimeve shpesh ishin të papërdorshme.

¹¹ Një shembull me të cilin u ndeshëm gjatë vizitës sonë informative në Prishtinë, lidhet me kërkimet në një minierë ku duhej të gjendeshin rreth tridhjetë kufoma Serbësh. Ndërmarrjet zonale të përdorura për kryerjen e punimeve u kërcënuan nga popullsia lokale, gjë që i vonoi mjaft kërkimet. Nga sa na thanë, qëndrimi i popullsisë kosovare është i tillë që e konsideron atë që jep të dhëna mbi varret e Serbëve si një “tradhtar”.

¹² Anketues të EULEX-it na vunë në dukje se bashkëpunimi me autoritetet shqiptare është “zero”. Përgjigja, pas shumë muajsh, për një kërkesë bashkëpunimi zyrtar ishte se hulumtimet e kërkuara (lidhur me kampin e Kukësit) “u vonuan për shkak të një katastrofe natyrore”. “Ndërkombëtarë” të tjerë na pohuan gjithashtu se ka një “qëndresë të fortë” nga ana e autoriteteve kosovare për të bashkëpunuar për zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur serbë e të ashtuquajturve “tradhtarë” kosovarë. Përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë na vërtetuan se Shqipëria asnjëherë nuk ka lejuar hapje varresh në territorin e saj: “Këtu, nuk ka patur luftë, pra nuk ka varre për të kërkuar”.

¹³ Ka pasur me sa duket ngurrime edhe brenda OMPF-së lidhur me zhdukjet e ndodhura pas 12 qershorit 1999.

16. E kemi vënë tashmë në dukje se si u bënë publike pohimet për trafikim organesh dhe se si ato morën një përmasë ndërkombëtare, aq sa e shtynë Asamblenë parlamentare të kërkojë hartimin e këtij raporti. Është folur shumë për “Shtëpinë e verdhë” që ndodhet në Rripe pranë Burrelit, në Shqipërinë qendrore. Gjithë vëmendja me sa duket është përqendruar në këtë shtëpi. Por ajo nuk është veçse një element i dorës së dytë i një çështjeje shumë më të gjerë e të ndërlikuar. Është e vërtetë se gjithçka duket se ka filluar nëpërmjet njoftimeve lidhur me “Shtëpinë e verdhë”. Në prill 2004, një vizitë vëzhgimi në vend u organizua bashkërisht nga GJPNIJ dhe UNMIK-u, me pjesëmarrje të një gazetari. Në fakt, nuk mund të flitet për një ekzaminim të vërtetë të policisë shkencore në bazë të krejt rregullave të artit. Pjesëmarrës të kësaj vizite që intervistua, denoncuan shprehimisht njëfarë mungese profesionalizmi, konkretisht për sa i përket marrjes së mostrave dhe konstatimeve shkencore. Megjithatë, qëndrimi i anëtarëve të familjes K. që jetojnë në atë shtëpi, ngjall shumë pikëpyetje, konkretisht lidhur me variantet e ndryshme dhe kontradiktore që dhanë një pas një për praninë e njollave të gjakut (të nxjerra nëpërmjet përdorimit të luminolit) pranë një tryeze të dhomës kryesore. Kryetari i familjes dha shpjegimin se kafshë të fermës ishin therur e rrjepur në atë vend, ndërkohë që u dha edhe shpjegimi tjetër sipas të cilit një nga gratë e shtëpisë kishte lindur foshnjën pikërisht aty.

17. As GJPNIJ, as UNMIK, as prokuroria shqiptare nuk e ndoqën më pas këtë vizitë për të ndërmarrë hetime më të thelluara. E jo vetëm kaq, por hetuesi shqiptar që kish marrë pjesë në vend në hartimin e procesverbalit, nuk do vononte të pohonte publikisht se nuk ekzistonte kurrfarë shenje e çfarëdollojshme. Gjurmët materiale të marra në vend, më pas u shkatërruan nga GJPNIJ, pasi u fotografuan, siç na e vërtetoi kryeprokurori i Gjykatës me anë të një letre.¹⁴ S’na mbetej tjetër veç të shprehnim habinë tonë.

18. Ekipi i Prokurorit të posaçëm për krimet e luftës në Beograd, që ka bërë përpjekje të konsiderueshme, nuk arriti as ai në rezultate shumë konkrete. Mediatizimi i fortë që përfshiu hetimin, sigurisht që s’kish si të ndihmonte në efektshmërinë e tij. Falënderojmë nga ana jonë prokurorin e posaçëm për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e tij.

19. Ekipi i prokurorëve dhe i hetuesve ndërkombëtarë në gjirin e misionit të EULEX-it, i ngarkuar për të hetuar lidhur me pohimet për trajtime çnjerëzore, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me një trafikim të mundshëm organesh, ka bërë përparime konkretisht për sa i përket provës së ekzistencës së vendeve të fshehta të burgimit të UÇK-së në Veri të Shqipërisë, ku do jenë kryer edhe vrasje. Mirëpo, ky hetim ndeshet gjer më sot me mungesën e bashkëpunimit nga ana e autoriteteve shqiptare që kanë lënë pa përgjigje kërkesën për bashkëpunim juridik të saktë e të hollësishëm, që u është drejtuar. Deri më sot, EULEX-i nuk ka arritur të hyjë në tërësinë e informatave të mbledhura nga GJPNIJ në këtë fushë.

20. Po ashtu, edhe hetimi i drejtuar nga EULEX-i në çështjen e klinikës Medicus në Prishtinë është vështirësuar nga ngadalësia e përgjigjeve të autoriteteve të shumë vendeve anëtare dhe vëzhguese të Këshillit të Europës ndaj kërkesave për ndihmë gjyqësore që u ka drejtuar EULEX-i.¹⁵ Duke pasur parasysh rëndësinë e fakteve të pohuara – trafikim organesh

¹⁴ Letër e Serge Brammertz, Kryeprokuror i GJPNIJ që mban datën e 17 dhjetorit 2009. Në një bisedë që kam pasur me Carla del Ponten më 2009, ish Kryeprokurorja më kishte siguruar se ai material do të ruhej në arkivat e GJPNIJ-së dhe se shkatërrimi i tyre as që mund të konceptohej.

¹⁵ Kërkesa të tilla u janë drejtuar në mars 2009 vendeve të mëposhtme : Gjermanisë, Bjellorusisë, Kanadasë, Federatës së Rusisë, Izraelit, Moldavisë, Polonisë dhe Turqisë. Në çastin e hartimit të këtij raporti, vetëm Kanadaja, me sa dimë, ka dhënë përgjigje të duhur.

njerëzore! – këto vonesa janë të pakuptueshme dhe të papranueshme. Kujtojmë se ky hetim çoi në arrestimin, në nëntor 2008, të një numri personash të implikuar. Mandate arrestimi u shpërndanë kundër personash të tjerë të dyshuar, aktualisht në arrati¹⁶. Ky hetim tregon gjithashtu praninë e infrastrukturave e të rrjeteve kriminale, ku përfshihen edhe mjekë, që veprojnë në rajon në kuadrin e një trafikimi ndërkombëtar të organeve njerëzore, pavarësisht nga prania e forcave ndërkombëtare. Do shohim se elementë mjaftueshmërisht seriozë e konkretë janë të pranishëm për të pohuar se ky trafikim ekzistonte tashmë para çështjes Medicus dhe se disa drejtues e simpatizantë të UÇK-së nuk kanë qenë të huaj në të. Në fund të fundit, dyshimi është i tillë sa që nuk duhet lejuar të mos çelet një hetim serioz, i pavarur dhe i plotë.

21. Rindërtimi i ngjarjeve gjatë periudhës së ndezur e kaotike në vitet 1999-2000 në Kosovë, është, siç e kemi parë, jashtëzakonisht i vështirë. Ka pasur dhe vazhdon të ketë, me përjashtim të disa hetuesve të EULEX-it, një mungesë vullneti për të zbardhur të vërtetën dhe për të përcaktuar përgjegjësitë lidhur me atë çka ndodhi gjatë asaj kohe. Tërësia e treguesve ekzistues kundër disa drejtuesve të lartë të UÇK-së shpjegon në pjesën më të madhe këto ngurrime. Ka dëshmitarë të këtyre ngjarjeve që janë eliminuar, të tjerë janë terrorizuar thjesht nga fakti se kërkohen në interpelancë për këto ngjarje. Nuk kanë absolutisht besim në masat mbrojtëse që mund t'u jepen. Me një numër bashkëbiseduesish, na është dashur të marrim masa tepër të rrepta për të siguruar anonimatën më të plotë. I kemi gjykuar si të denjë për t'u besuar, dhe kemi mundur të konstatojmë se deklaratat e tyre vërtetoheshin nga elementë objektivisht të verifikueshëm. Megjithatë, qëllimi ynë nuk ishte të kryenim një hetim kriminal. Por prapë, themi se kemi mbledhur elementë mjaftueshmërisht të rëndësishëm për të kërkuar me forcë që instancat ndërkombëtare dhe shtetet përkatëse të bëjnë më në fund gjithçka që e vërteta të dalë në shesh dhe përgjegjësit të identifikohen qartë e të japin llogari për aktet e tyre. Treguesit e lidhjes midis kriminalitetit dhe personave të veshur me përgjegjësi politike e funksione institucionale janë tepër të shumtë dhe tepër seriozë për të mos u marrë parasysh. Është një e drejtë themeltare e qytetarëve kosovarë për të njohur të vërtetën, krejt të vërtetën; është po ashtu një kusht i domosdoshëm për një pajtim midis bashkësive dhe për një të ardhme të lulëzuar të vendit.

22. Përpara se të hyjmë në hollësi të kërkimeve tona, do desha të falënderoj të gjithë ata e të gjithë ato që më kanë ndihmuar në këtë punë sa të vështirë aq edhe delikate. Fillimisht sekretariatit e komisionit, që më siguroi një ekspert të jashtëm, autoritetet e shteteve të vizituara, si dhe gazetarë hulumtimesh kompetentë e të guximshëm që ndanë disa të dhëna me ne. Një falënderim të veçantë për personat që kanë pasur besim në profesionalizmin tonë, konkretisht në detyrën tonë për të mbrojtur identitetin e tyre që të mos viheshin në rrezik.

2. Koment fillestar rreth burimeve

23. Gjatë hetimit tonë, ne mblodhëm dëshmi e dokumente nga mjaft duzina burimesh kryesore, tek të cilat figurojnë: luftëtarët dhe përkrahësit e grupimeve të armatosura që morën pjesë në luftimet e Kosovës; viktimat e drejtpërdrejta të akteve të dhunës të kryera në Kosovë dhe në territoret përreth; anëtarët e familjeve të personave të zhdukur apo të vdekur; përfaqësuesit e sotëm dhe të djeshëm të institucioneve gjyqësore ndërkombëtare që kanë

¹⁶ Shih komunikatën e shtypit të EULEX-it të 15 tetorit 2010:

www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0098.php si dhe artikullin e Nebi Qena (AP) të 12 nëntorit 2010: http://news.yahoo.com/s/ap/20101112/ap_on_re_eu/eu_kosovo_organ_trafficking/print.

njohur ngjarjet në Kosovë [duke filluar nga Misioni administrues i përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Misioni europian i policisë e i drejtësisë në Kosovë (EULEX) dhe Gjykata penale ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (GJPNIJ)]; përfaqësuesit e sistemeve gjyqësore kombëtare, midis të cilëve prokurorët kompetentë për faktet e lidhura me Kosovën [shërbimi i prokurorit të ngarkuar me krimet e luftës në Beograd; prokurori i përgjithshëm i Tiranës; prokurorët, funksionarët e policisë dhe veprimtarët e sigurisë publike të Prishtinës dhe të tre shteteve fqinje]; agjencitë humanitare [midis të cilave Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq]¹⁷ dhe Komisioni ndërkombëtar për personat e zhdukur (ICMP)]; më në fund, anëtarët e ndryshëm të shoqërisë civile dhe të instancave mbrojtëse të të drejtave të njeriut, që kanë hetuar mbi ngjarjet e ndodhura në Kosovë gjatë periudhës që na intereson dhe që kanë dhënë llogari për to [duke përfshirë edhe Qendrën e së drejtës humanitare].

24. Sigurisht, ne u përpoqëm, në çdo rast që ishte e mundur, t'i mblidhnim vetë drejtpërdrejt këto dëshmi, qoftë gjatë mbledhjesh zyrtare, qoftë nëpërmjet bisedimesh konfidenciale, gjatë vizitave të bëra në Prishtinë, Tiranë e Beograd dhe në rajone të tjera të Ballkanit. Megjithatë, disa burime që na dhanë këto dëshmi nuk ishin në gjendje të na takonin personalisht për arsye të ndryshme, midis të cilave figurojnë “zhdukja” e tyre për shkaqe sigurie, transferimi i tyre jashtë shtetit dhe shtrëngesat e programit zyrtar të mbledhjeve të parashikuara gjatë misionit tonë në rajon.

25. Nga ana tjetër, në marrjen e dëshmive të denja për t'u besuar lidhur me pohimet për krime të kryera nga Kosovarë shqiptarë, ne hasëm në po ato vështirësi që kishin njohur edhe instancat e tjera hetimore gjatë dhjetë vjetëve të fundit. Ndjenja e ngulitur thellë e besnikërisë ndaj klanit, si dhe koncepti i nderit, të cilat i ka përcaktuar ndoshta më mirë raporti i ekspertizës së paraqitur në GJPNIJ gjatë shqyrtimit të çështjes Limaj dhe shq.¹⁸, na bllokoi çdo kontakt me shumicën e dëshmitarëve të etnisë shqiptare. Duke pasur parasysh faktin që dy veprime të mëdha drejtësie të ndërmarra nga GJPNIJ kishin shkaktuar vdekjen e një numri aq të madh dëshmitarësh, gjë që pengoi përfundimisht që drejtësia të vihej në vend¹⁹, ishte shumë pak e mundshme që një reporter i Asamblesë, mjetet e të cilit ishin qesharake në do viheshin në peshë, të arrinte që këta dëshmitarë të na drejtoheshin drejtpërdrejt neve.

26. Një numër i madh personash që punuan gjatë viteve në Kosovë, dhe që bëjnë pjesë në radhët e vëzhguesve më të respektuar në fushën e drejtësisë në rajon, na vunë në dukje se rrjetet shqiptare të kriminalitetit të organizuar (“mafia shqiptare”) të vendosura në Shqipëri, në vendet fqinje, konkretisht në Kosovë dhe në “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë”, si dhe në gjirin e diasporës shqiptare ishin, sipas gjasave, më të vështira se Mafia italiane për të depërtuar në to; ekzekutuesit e thjeshtë, që gjenden në fund të shkallës hierarkike të këtyre rrjeteve, do të parapëlqenin të qëndronin dhjetëra vite në burg apo të dënoheshin qoftë edhe për pengesë drejtësie, sesa të dorëzonin një anëtar të klanit të tyre.

27. Kemi qenë pra të detyruar, por vetëm kur nuk kishim rrugë tjetër, të mbështeteshim mbi regjistrime bisedash audio e video, në të cilat burime themelore pyeteshin nga të tjerë persona dhe jo nga ne. Në këtë rast, kemi bërë gjithçka të mundur për të kërkuar identitetin, vërtetësinë dhe besueshmërinë e këtyre burimeve; dëshmitë e tyre i krahasuam me të dhëna të tjera të mbledhura pranë burimeve të veçanta e të pavarura, pa pasur mes tyre kurrfarë

¹⁷ CICR ka transmetuar vetëm të dhëna jo konfidenciale lidhur me personat e zhdukur.

¹⁸ Përmendur në vendimin Limaj.

¹⁹ Vetë Carla del Ponte deklaroi lidhur me procesin Limaj se “modërimi, i ushqyer nga frika, ishte në gjendje të mbisundonte”. Shih Del Pont e Sudetic, *The Hunt*, kreu 11: *Confronting Kosovo*, f. 26.

njohjeje; më në fund, morëm drejtpërdrejt nga vetë personat që hynin në këto bashkëbisedime, të dhëna mbi rrethanat dhe kushtet në të cilat ishin zhvilluar këto biseda.

28. Këto bashkëbisedime janë zhvilluar nga përfaqësues të shërbimeve ndëshkimore të vendeve të ndryshme, nga hulumtues e universitarë, si dhe nga gazetarë investigues me një reputacion e besueshmëri të njohur. U përkujdesëm në mënyrë sistematike për të mbështetur dëshmi të tilla.

3. Rezultatet e hollësishme të kërkimeve tona

3.1. Një vështrim tërësor

29. Një vështrim tërësor që del nga anketimi ynë ndryshon shumë në mjaft drejtime nga tabloja që jemi mësuar zakonisht të shohim për konfliktin në Kosovë. Faktikisht, me gjithë intensitetin e pamohueshëm të luftës së bërë për fatin e territorit të Kosovës, grupimet armiqësore rrallë janë ndeshur në luftime të armatosura përgjatë ndonjë vije frontale të çfarëdoshme.

30. Dhunimet e urryera të bëra nga ushtarët dhe forcat e policisë serbe, që përpiqeshin të nënshtronin, dhe më pas të dëbonin popullsinë shqiptare të Kosovës, janë të njohura publikisht dhe të përcaktuara më se qartë.

31. Rëndësia e elementëve të provës që kemi zbuluar ka të bëjë ndoshta e sidomos me faktin se ato shpesh janë në kontradiktë me pamjen joshëse të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, paraqitur si një ushtri guerilasish që kanë luftuar trimërisht për të mbrojtur të drejtën e bashkëpatriotëve të tyre për të jetuar në territorin e Kosovës.

32. Nëse është e pamohueshme se shumë ushtarë të guximshëm, të gatshëm për të shkuar në luftë e për t'i bërë ballë kundërshtarit, për të vdekur, në rast nevoje, për kauzën e një atdheu kosovar shqiptar të pavarur, ishin të pranishëm në radhët e UÇK-së, përsëri këta nuk përbënin detyrimisht shumicën.

33. Sipas dëshmimeve që ne kemi arritur të mbledhim, politika dhe strategjia e ndjekur nga disa drejtues të UÇK-së shkonte përtej ambicies së thjeshtë për mposhtjen e shtypësve serbë.

34. Nga njëra anë, udhëheqja e UÇK-së u përpoq të arrinte njohjen dhe mbështetjen e partnerëve të huaj, midis të cilëve figurojnë konkretisht qeveria e Shteteve të Bashkuara. Për këtë qëllim, “zëdhënësit” e UÇK-së, që mbanin kontakte të shkëlqyera në skenën ndërkombëtare, duhej t'u jepnin një numër garancish partnerëve e kontribuesve të tyre dhe/apo të merrnin përsipër zotime konkrete që përbënin faktikisht kushtet për arritjen e mbështetjes nga jashtë.

35. Nga ana tjetër, një numër kuadrosh të lartë të UÇK-së nuk do kenë munguar të përfitojnë nga lufta, konkretisht në formë përfitimesh materiale e personale. Synimi i tyre duhet të ketë qenë të përfitonin apo t'u siguronin anëtarëve të familjeve të tyre a të klanit që përfaqësonin një numër burimesh në të ardhura, për shembull nëpërmjet ushtrimit të funksioneve publike apo veprimtarive në fushat fitimprurëse, si sektori i naftës, ndërtimet dhe qiradhënia. Sipas tyre, po vihej në vend ajo që konsideronin si padrejtësi, nga e cila kishte qenë viktimë popullsia shqiptare e ish Jugosllavisë. Një numër i madh prej tyre do jenë përpjekur të

përfitonin sa më shumë nga pushteti që kishin gjatë kohës kur disa zona jashtë ligji ishin vendosur nën autoritetin e tyre veprues (si në disa pjesë të Kosovës jugore dhe perëndimore) dhe të përdornin ndikimin e tyre, sidomos për sa i përket burimeve financiare, për t'u vendosur në vende të tjera (për shembull në Shqipëri).

36. Në realitet, veprimtaritë kryesore operative të anëtarëve të UÇK-së para, gjatë dhe menjëherë pas konfliktit kryeshin në territorin shqiptar, ku forcat serbe të sigurimit nuk kanë qenë asnjëherë.

3.2. Tarafizimi i UÇK-së dhe lidhjet me krimin e organizuar

37. Gjatë më shumë se dy vjetëve pas shfaqjes së saj të parë më 1996, UÇK-ja konsiderohej nga vëzhguesit perëndimorë si një grup marginal dhe i çorganizuar kryengritësish, sulmet e së cilës kundër shtetit jugosllav ngjasonin me aktet e “terrorizmit”.

38. Burimet tona pranë UÇK-së si dhe dëshmi nga anëtarë të UÇK-së të zënë robër nga policia serbe vërtetojnë se bazat kryesore të UÇK-së ku mblihdeshin rekrutët e saj ndodheshin në Veri të Shqipërisë.

39. Është vërtetuar tashmë më së miri se armët dhe municionet futeshin kontrabandë në rajone të ndryshme të Kosovës, shpesh me kafshë të ngarkuara që nga Veriu i Shqipërisë, nëpërmjet rrugësh malore të përdorura në fshehtësi. Sipas policisë serbe, bëhej fjalë për goditje kriminale të kryera nga keqbërës që parashikonin të bënin akte terroriste kundër forcave serbe të sigurisë. Kosovarët shqiptarë dhe shtetasit shqiptarë që merrnin pjesë në këto operacione kontrabande i paraqisnin ato në të kundërt si akte heroike qëndrese ndaj shtypjes serbe.

40. Forcimi i aftësisë luftarake dhe i besueshmërisë së UÇK-së tek popullsia shqiptare e Kosovës, me sa duket ka ndjekur, sidomos gjatë vitit 1998, një trajektore të ngjashme me përshkallëzimin e akteve të egra të kryera nga ushtria dhe policia serbe.

41. Dhe vetëm në gjashtëmuorin e dytë të vitit 1998, UÇK-ja arriti të imponohet në mendjen e bashkësisë ndërkombëtare, falë mbështetjes së hapur të fuqive perëndimore bazuar në “lobingun” e Shteteve të Bashkuara, si tehu i luftës së Kosovarëve shqiptarë për çlirimin e Kosovës.

42. Fakti që UÇK-ja u shfaq si një aktor i dorës së parë ishte i rëndësishëm, por ishte njëkohësisht edhe karta e saj më e çmuar. Në fakt, kjo gjë nxiti donatorët më të kamur të diasporës shqiptare për të dërguar fonde të konsiderueshme tek UÇK-ja. Kjo paraqitje bëri që çdo përfaqësues i UÇK-së ta shihte autoritetin e tij në rritje, gjë që i bënte të mundur të fliste e të vepronte në emër të krejt Shqiptarëve të Kosovës, ndërkohë që personalitete të dorës së parë të UÇK-së shfaqeshin si zotëruesit e mundshëm të pushtetit në Kosovën e pasluftës.

43. Ky rol i dukshëm, i veçantë i UÇK-së, që i detyrohet në pjesën më të madhe Amerikanëve, ishte në fakt i parashikueshëm dhe përbënte bazën mbi të cilën u mbështet UÇK-ja për të dalë mbi forcat e tjera politike shqiptare që synonin pushtetin, si Lidhja demokratike e Kosovës (LDK) e Ibrahim Rugovës dhe “qeveria në mërgim” e Bujar Bukoshit.

44. Sipas burimeve që disponojmë nga brenda, UÇK-ja i kushtoi po aq energji, e me sa duket, një pjesë të rëndësishme të burimeve të veta dhe të kapitalit të saj politik, ruajtjes së

përparësisë ndaj grupimeve rivale të etnisë shqiptare, sa dhe realizimit të veprimeve ushtarake të koordinuara kundër Serbëve.

45. Paralelisht, duhet të kujtojmë, për ta vënë më mirë në dukje, se Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk përbënte një grupim të vetëm e të bashkuar luftëtarësh, sipas mënyrës së një ushtrie konvencionale. Nuk kishte një drejtues më të lartë apo një “kryekomandant”, caktuar zyrtarisht, që autoriteti i tij të njihej botërisht nga komandantët e tjerë dhe që urdhrat të zbatoheshin nga krejt trupa.

46. Përkundrazi, ndërsa lufta për pushtet në Kosovën e ardhme po njihte evolucion dhe përhapja e konfliktit po afrohej, një tarafizim i brendshëm me rrënjë të thella po përcante UÇK-në.

47. Ambiciet e kundërta politike të personaliteteve më të rëndësishme të UÇK-së dhe të kandidatëve të saj për drejtim, si dhe një konceptim i kontrastuar lidhur me parametrat e pranueshëm të qëndrësës së armatosur përbënin burime të rëndësishme përçarjeje.

48. Shumë “grupëzime” të ndryshme të UÇK-së u shfaqën në këtë mënyrë më 1998 e 1999, konkretisht pas vdekjes së komandantit të famshëm fshatar të UÇK-së Adem Jashari.²⁰

49. Secili nga grupëzimet drejtohej nga një prej anëtarëve themelues të vetëshpallur të UÇK-së dhe kishte rreth vetes një bërthamë besnike rekrutësh e përkrahësish, shpesh të dalë nga disa klane apo familje të lidhura ngushtë dhe/apo që përqendroheshin mbi një zonë gjeografike të dhënë të Kosovës. Çdo grup e konsideronte drejtuesin e tij si më të aftin për të drejtuar luftën e UÇK-së kundër Serbëve dhe më gjerësisht, për të arritur vet-vendosjen e Shqiptarëve të Kosovës, krahas bashkëpunimit, në kuadër të oportunitetit, me komandantët e tjerë të UÇK-së.

50. Anëtarët dhe drejtuesit e këtyre grupëzimeve, si dhe popullariteti që gëzonte tashmë më parë LKD-ja sigurisht që mbijetuan pas konfliktit, e në thelb, formuan peizazhin politik, të Kosovës së pasluftës.²¹

51. Gjatë dhjetë vjetëve të fundit, ish komandantët kryesorë të UÇK-së kanë ndarë midis tyre ushtrimin e funksioneve më të larta drejtuese të Kosovës; në shumicën e fushatave elektorale, kandidatët janë ndeshur duke nxjerrë në pah pjesëmarrjen e tyre përkatëse në luftën për çlirim dhe aftësinë e tyre për mbrojtjen e interesave të popullsisë shqiptare të Kosovës ndaj kundërshtarëve të saj të njohur e të panjohur.

²⁰ UÇK-ja u zhvillua në Kosovë gjatë pjesës më të madhe të viteve 90, duke mbledhur rreth vetes luftëtarë vullnetarë, njerëz të çdo moshe dalë nga fshatrat e tyre për t'u bashkuar rreth prijësash të tillë si Adem Jashari, dhe për të krijuar njësi të vogla të armatosura, apo “brigada” në krejt territorin e Kosovës. Shumë rekrutë të kësaj “UÇK-je patriotë”, që përbënin efektivisht një ushtri fshatare, kanë ndjekur stërvitje për luftime guerile në kampet e ngritura në Veri të Shqipërisë dhe kanë kaluar në Kosovë armë kontrabande, me të cilat do të kryheshin veprime qëndrese të armatosur. Kemi mbledhur gjatë hetimit tonë mbi një duzinë dëshmish nga njerëz që i përkasin etnisë shqiptare, të cilët kanë marrë pjesë në këtë fushatë “qëndrese”. Kur Jashari dhe shumë anëtarë të familjes së tij, si dhe të tjerë që i shkonin pas gjetën vdekjen gjatë represionit të organizuar nga forcat serbe të sigurisë më 1998, kjo formë fillestare e UÇK-së mori fund përfundimisht dhe hyri në folklor si një shprehje romantike për çlirimin e Kosovës, për të cilën Jashari u shndërrua në martir.

²¹ Partitë kryesore politike kundërshtarë të serive të zgjedhjeve të kohëve të fundit kanë qenë Partia demokratike e Kosovës, apo PDK, dhe Aleanca për të Ardhmërinë e Kosovës apo AAK, të cilat janë që të dyja të drejtuara nga komandantët të ish “grupëzimeve” të UÇK-së dhe kanë në radhët e tyre si anëtarë një numër të madh ish luftëtarësh të UÇK-së.

52. Ka dalë qartë se këto “grupëzime” të ndryshme të UÇK-së kanë zhvilluar e ruajtur strukturat e tyre informative, që i kishin ndër të tjera, si një mjet për të siguruar vazhdimësinë e tyre. Përkrahësit më të zellshëm të ndjekjes faktike të kësaj forme lufte të UÇK-së përdorën të gjitha mjetet që kishin, duke e vënë veten, në mënyrë të pamohueshme, në kufirin e ligjshmërisë, për të mbikëqyrur dhe shpesh për të sabotuar veprimin e kundërshtarëve, si dhe të atyre që mund të dëmtonin interesat e tyre politike a ekonomike.²²

53. Kemi konstatuar²³ nga ana tjetër se strukturat e njësive të UÇK-së i ishin përshtatur në pjesën më të madhe hierarkisë, detyrimeve për besnikëri e bindje, si dhe kodit të nderit të klaneve apo familjeve të mëdha të etnisë shqiptare, që formojnë një tërësi rregullash të njohura nën emrin *kanun* në rajonet e Kosovës nga kanë dalë komandantët e tyre.

54. Nisur nga analizat që na kanë komunikuar shumë misione ndërkombëtare të kontrollit, dhe që mbështeten nga burimet që ne kemi pranë forcave europiane të rendit, si dhe nga ish luftëtarë të UÇK-së, kemi konstatuar se njësitë kryesore të UÇK-së dhe zonat e tyre përkatëse të komandimit operativ ishin pothuaj kopje e saktë e strukturave që kontrollonin format e ndryshme të kriminalitetit të organizuar në territoret ku vepronte UÇK-ja.

55. Më thjeshtë, për të kuptuar kush drejtonte trafikimet e ndryshme apo veprimtaritë e kontrabandës, që lulëzonin në rajon, mjafton të përcaktohet cili taraf apo cili klan komandantësh a rekrutësh të UÇK-së ishte përgjegjës i një zone operative të përcaktuar të UÇK-së në Kosovë apo në disa rajone të Shqipërisë.

56. Kemi bërë edhe një konstatim tjetër nga më të përpiktët e hetimit tonë: një bërthamë e ngushtë, por çuditërisht e fuqishme personalitetesh të UÇK-së, duhet ketë marrë kontrollin, shumë-shumë duke filluar nga viti 1998, të pjesës më të madhe të veprimtarive kriminale të paligjshme, në të cilat Shqiptarët e Kosovës kanë marrë pjesë në Republikën e Shqipërisë.

57. Ky grup personalitetesh të rendit të parë të UÇK-së është vet-pagëzuar “Grupi i Drenicës”, një emër ky që të kujton lidhjet e tij me luginën e Drenicës në Kosovë²⁴, bërthama tradicionale e qëndresës së anëtarëve të etnisë shqiptare ndaj shtypjes serbe në kohën e Millosheviçit dhe vendlindja e UÇK-së.

58. Kemi konstatuar se drejtuesi i këtij “Grupi të Drenicës”, apo për të përdorur vetë terminologjinë e rrjeteve të kriminalitetit të organizuar, “kumbara” e tij, nuk ishte tjetër veçse një aktor i njohur i jetës politike lokale dhe ndoshta personaliteti i UÇK-së më i njohuri në skenën ndërkombëtare, Hashim Thaçi.²⁵

²² Kemi regjistruar në këtë drejtim pohimet e vlefshme të Nazmi Bllacës, që u vetparaqit dhe deponoi vitin e shkuar duke theksuar se këto shërbime informative kryenin vrasje të piketuara dhe përdornin forma të ndryshme zhvatjesh; tabloja e kësaj bote të fshehtë pasqyruar nga Bllaca përputhet me atë që ne kemi zbuluar gjatë kërkimeve tona.

²³ Në këtë drejtim, konstatimet tona përputhen me konkluzionet e paraqitura nga përfaqësuesit ndërkombëtarë të misionëve të kontrollit të ushtrisë e të shërbimeve informative – që prej Forcës së stabilitetit të NATO-s për Kosovën (KFOR), gjer te Organizata për sigurinë dhe bashkëpunimin në Europë (OSCE), duke kaluar nga Central Intelligence Agency (CIA) e Shteteve të Bashkuara – në raporte të botura për çështje të ndryshme gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit.

²⁴ Zona e ndikimit e Grupit të Drenicës dhe përkrahësve të tij në Kosovë, në fakt është shtrirë shumë më përtej këtij vendi të përcaktuar: ata kontrollonin në fakt fuqimisht kartelet kriminale që ushtronin veprimtaritë e tyre konkretisht, por jo ekskluzivisht, në komunat e Istokut, Srbicës, Skënderajt, Klinës, Prizrenit e Prishtinës.

²⁵ Shih, për shembull, gazetën *le Monde* të 11 dhjetorit 2010, “Hashim Thaçi, njeriu i fortë i Kosovës, në kërkim të mirënjohjes”.

59. Thaçi mund të konsiderohet si artizan i ngjitjes së UÇK-së drejt një statusi prej aktori të dorës së parë në periudhën që i parapriu bisedimeve të Rambujesë, si në terren në Kosovë, ashtu dhe jashtë shtetit. Ka ndihmuar gjithashtu shumë në shfaqjen e një fraksionimi të thellë të brendshëm që karakterizonte UÇK-në gjatë viteve 1998 dhe 1999.

60. Nga njëra anë, Thaçi ia detyron pa asnjë dyshim ngjitjen e tij personale përkrahjes politike e diplomatike²⁶ të Shteteve të Bashkuara dhe të fuqive të tjera perëndimore, të cilat e konsideronin si partnerin lokal më të parapëlqyer në projektin e tyre të politikës së jashtme për Kosovën. Kjo formë përkrahjeje politike do t'i ketë krijuar konkretisht ndjenjën se është "i paprekshëm" dhe e veshi kështu me një rëndësi tej mase prej drejtuesi të ardhshëm, të besueshëm, të Kosovës së pasluftës.

61. Nga ana tjetër, sipas raporteve të dokumentuara më së miri të shërbimeve informative, që i kemi studiuar në thellësi, dhe që mbështeten edhe nga takimet që kemi pasur gjatë anketimit tonë, "Grupi i Drenicës" i drejtuar nga Thaçi e përforcoi në përmasa fenomenale mbështetjen e tij mbi veprimtaritë kriminale të organizuara gjatë kohë kur këto lulëzuan në Kosovë e në Shqipëri.

62. Thaçi do ketë vepruar në këtë fushë me mbështetjen dhe bashkëfajësinë jo vetëm të strukturave qeverisëse zyrtare të Shqipërisë, dhe konkretisht të qeverisë socialiste në pushtet në atë kohë, por edhe të shërbimeve sekrete shqiptare dhe të mafias së tmerrshme shqiptare.

63. Shumë komandantë të UÇK-së mbetën në territor shqiptar, disa duke vepruar madje edhe nga kryeqyteti, Tirana, gjatë gjithë periudhës së luftës e më tej.

64. Gjatë kohës së bombardimeve të kryera nga NATO-ja, e që zgjatën shumë javë, ekuilibri i pushteteve në Kosovë ndryshoi doemos kryesisht nga vërshimi në rajon i shtetasve të huaj, ardhur zyrtarisht apo gjysmë-zyrtarisht për të mbështetur kauzën e UÇK-së. Kjo mbështetje e huaj, që arrinte me vështirësi të depërtonte në Kosovë, do të kalonte transit kryesisht nga Shqipëria.

65. Shumë funksionarë të lartë të UÇK-së - duke u nxitur nga mundësia për strehim që iu dha në mënyrë të heshtur nga autoritetet shqiptare, në mbështetje të kauzës së tyre, të bindur gjithashtu se ishte më praktike për ta të vijonin veprimtaritë e tyre në një terren që e njihnin -, do kenë ngritur sistemin e tyre të zhvatjeve, në shpërblim të mbrojtjes së tyre në zonat e Shqipërisë sunduar nga anëtarët e klanit të tyre apo ku gjetën një terren marrëveshjeje me kriminalitetin e organizuar që kish qenë vendosur aty dhe që zhvillonte veprimtari të tilla si trafiku i qenieve njerëzore, shitja e mjeteve të vjedhura dhe tregtia e seksit.

66. Shërbimet e ngarkuara me luftën kundër trafikut të drogës të paktën të pesë vendeve, përcaktojnë me saktësi në raporte sekrete që shtrihen për një periudhë mbi dhjetëvjeçare, se tregtia e heroinës dhe e narkotikëve të tjerë kontrollohej në mënyrë të dhunshme nga Hashim Thaçi dhe anëtarë të tjerë të "Grupit të Drenicës".²⁷

²⁶ Thaçi për shembull ka qenë emëruar kryetar i delegacionit të Shqiptarëve të Kosovës në Samitin e Rambujesë.

²⁷ Administrata amerikane e ngarkuar me luftën kundër trafikut të drogës (*Drug Enforcement Administration*) ka vënë kështu në dukje në një raport të botuar në pranverë 1999 se organizatat e trafikantëve të drogës të përbëra nga Shqiptarë të Kosovës "zinin vendin e dytë, menjëherë pas gangëve turq, në trafikun e heroinës të qarkut të Ballkanit".

67. Po ashtu, analistë të shërbimeve informative të NATO-s, si dhe ata të katër qeverive të huaja, të paktën të pavarur²⁸, kanë bërë një konstatim të pamohueshëm duke mbledhur të dhëna për periudhën që pasoi menjëherë konfliktin e vitit 1999. Thaçi zakonisht përcaktohej e cilësohej në raportet e shërbimeve sekrete si më i rrezikshmi i “kumbarëve të llumit” të UÇK-së.²⁹

68. Gjatë hulumtimeve tona, kemi pasur të dhëna se shumë anëtarë të tjerë të njohur të “Grupit të Drenicës” kanë qenë bashkëfajtorët kryesorë të llojeve të ndryshme të veprimtarive kriminale. Ndër ta figurojnë Xhavit Haliti, Kadri Veseli, Azem Sylja e Fatmir Limaj. Gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit, secili prej tyre ka qenë objekt akuzash të shumta pas dyshimesh për krime lufte apo për bashkëfajësi me keqbërës, përfshirë edhe për çështje të rëndësishme që u janë drejtuar prokurorëve të UNMIK-ut, të GJPNIJ- së³⁰ dhe EULEX-it. Deri më sot, ata të gjithë i kanë shpëtuar çdo drejtësie efektive.

69. Gjithçka të lë të besosh se këta individë do duhej të ishin dënuar për krime të rënda dhe do duhej të vuanin sot ndëshkime afatgjata burgimi nëse mosndëshkimi i tyre nuk do që siguroar nga dy faktorë tronditës: në radhë të parë, me sa duket, ata kanë arritur të eliminojnë apo të detyrojnë me heshtje nëpërmjet frikësimit pjesën më të madhe të dëshmitarëve të mundshëm apo të vërtetuar (si armiqtë e tyre, ashtu dhe aleatët e vjetër), duke përdorur dhunime, kërcënime, shantazhe dhe allishverishe; së dyti, ka pasur një mungesë vullneti politik nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për të goditur seriozisht ish drejtuesit e UÇK-së. Kjo me sa duket e ka lejuar Thaçin – e rrjedhimisht edhe anëtarët e tjerë të “Grupit të Drenicës” – të përfitojë nga pozita e tyre dhe të grumbullojë pasuri personale pa lidhje me veprimtaritë e tyre të deklaruara.

70. Thaçi dhe anëtarët e tjerë të “Grupit të Drenicës” janë cilësuar vazhdimisht si “aktorët kyç” në raportet e shërbimeve informative kushtuar strukturave të llojit mafioz të kriminalitetit të organizuar të Kosovës³¹. Unë i kam shqyrtuar këto raporte voluminoze me një ndjenjë shtangjeje përzier me indinjatë morale.

71. Në mënyrë të veçantë është e habitshme të vërehet se tërësia e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë – që prej qeverive të Shteteve të Bashkuara dhe të fuqive të tjera perëndimore aleate, gjer te autoritetet gjyqësore që ushtrojnë veprimtaritë e tyre nën tutelën e Bashkimit

²⁸ Është fjala ndër të tjera për shërbimet informative gjermane (BND), italiane (SISMI), britanike (MI6) dhe greke (EYP).

²⁹ Shih për shembull raportin e *Institut für Europäische Politik*, Berlin, 9 janar 2007 hartuar nga ministria federale gjermane e Mbrojtjes («Operationalisierung von Security Sector Reform (SSR) auf dem Westlichen Balkan – intelligente/kreative Ansätze für eine langfristig positive Gestaltung dieser Region»); dokumenti, i klasifikuar sekret, megjithatë ishte i disponueshëm në internet; në faqen 57, autorët theksojnë se “Thaçi konsiderohet në qarqet e sigurimit si shumë më i rrezikshëm nga Haradinaj, i cili, si ish drejtues i UÇK-së zotëron rrjete kriminale më të gjera në rrafsh ndërkombëtar”. (përkthim i bërë nën përkujdesin tonë).

Një tjetër raport i shërbimit informativ gjerman (*Bundesnachrichtendienst/BND*), po ashtu i klasifikuar sekret, por i disponueshëm në internet (BND Analyse vom 22 shkurt 2005) i cilëson ZZ. Haliti, Thaçi, Lluka e Haradinaj si personalitetet kyçe të kriminalitetit të organizuar në Kosovë dhe shtjellon në 27 faqe analizash të dendura, konkretisht degëzimet e “Grupit të Drenicës”.

Ne nuk u kufizuam thjesht në studimin e këtyre raporteve dhe të tjerave, por në përpunimin e tyre, ne hymë në kontakt dhe biseduam në terren edhe me shumë persona drejtpërdrejt të implikuar.

³⁰ Fatmir Limaj, ish komandant i rangut të lartë të UÇK-së u muar në shqyrtim, u gjykua dhe përfundimisht u lirua nga GJPNIJ gjatë një procedure që hasi shumë probleme integriteti prove.

³¹ Gjatë dhjetë vjetëve të fundit, shërbimet informative të shumë vendeve perëndimore, shërbimet represive si *Federal Bureau of Investigation (FBI)*, në Shtetet e Bashkuara dhe analistë të kombësive të ndryshme që punojnë për strukturat e NATO-s, kanë hartuar, mbi bazën e të dhënave të shëndosha burimore, raporte me peshë, dhe që mbështesin njëri-tjetrin lidhur me veprimtaritë e paligjshme të këtij “Grupi të Drenicës”.

European – zotëron pa dyshim të njëjtat informacione dërrmuese për tërë gamën e krimeve të bëra nga “Grupi i Drenicës”³², por asnjë prej tyre nuk duket i gatshëm për të reaguar përballë një gjendjeje të tillë dhe për të ndjekur penalisht përgjegjësit.

72. Burimet e drejtpërdrejta që disponojmë tregojnë në mënyrë të besueshme se Haliti, Veseli, Sylja e Limaj, si dhe Thaçi e anëtarët e tjerë të rrethit të bashkëpunëtorëve të tyre të ngushtë, do kenë urdhëruar, e ndonjëherë do kenë ndjekur edhe personalisht, realizimin e një numri vrasjesh, burgosjesh, agresionesh dhe marrjesh në pyetje, në rajone të ndryshme të Kosovës dhe konkretisht, çka na intereson në mënyrë më të veçantë, gjatë operacioneve të kryera nga UÇK-ja në territorin shqiptar, në vitet 1998-2000.

73. Anëtarët e “Grupit të Drenicës” duhet të kenë marrë gjithashtu në dorë kontrollin e fondeve themelore të vëna në dispozicion të UÇK-së për të financuar përpjekjet e luftës.³³ Ky grup duhet të ketë bërë me rrjetet ndërkombëtare të kriminalitetit të organizuar shumë marrëveshje që duhet t’i ketë dhënë mundësinë për t’u zgjeruar dhe për t’u përhapur në fusha të reja veprimtarie, krahas rrugëve të reja të kontrabandës drejt vendesh të tjera të Europës.

74. Më konkretisht, sipas vëzhgimeve tona, përgjegjësia e parë për dy seritë e krimeve të papranuara dhe të përmendura në këtë raport, duket se bie mbi drejtuesit e “Grupit të Drenicës”: administrimi i rrjetit ad hoc të qendrave të burgimit të UÇK-së në territorin shqiptar³⁴ dhe përcaktimi i fatit të robërve të ruajtur në këto qendra, dhe konkretisht civilë të shumtë rrëmbyer në Kosovë dhe dërguar përtej kufirit, në Shqipëri.

75. Kur ne u përpoqëm të kuptojmë se si këto akte kriminale kishin arritur një shkallë të tillë të veçantë çnjerëzimi, domethënë duke shkuar gjer në marrje të detyruar organesh njerëzore me qëllim trafikimi, identifikuam një tjetër personalitet të UÇK-së që duket që bën pjesë në radhën e parë të aktorëve bashkëfajtorë të këtyre akteve: Shaip Muja.

76. Biografia personale e Shaip Mujës në luftën për çlirimin e Shqiptarëve të Kosovës i ngjan, deri në njëfarë pike, asaj të anëtarëve të tjerë të “Grupit të Drenicës”, ndër të cilët vetë Hashim Thaçit : militant student në fillim të viteve 90³⁵, ai u bë një nga anëtarët e grupit elitari

³² E pakta që mund të thuhet është se ekzistojnë prova të shëndosha dokumentuese që lejonë të vërtetohet se ky grup dhe ortakët e tyre financiarë kanë marrë pjesë në veprimtari për pastrim parash, për kontrabandë droge e cigaresh, për trafik qeniesh njerëzore dhe prostitucion, krahas një monopolizimi të dhunshëm të sektorëve më të rëndësishëm ekonomikë, ndër të cilat karburantet dhe ndërtimi.

³³ Këto fonde vinin para së gjithash nga kontributet e derdhura nga diaspora kosovare; ishin vënë në llogari bankare të huaja, konkretisht në Gjermani e Zvicër. Mjetet financiare të vëna në dispozicion të Thaçit e të rrethit të bashkëpunëtorëve të tij u shtuan në mënyrë të konsiderueshme me krijimin e një fondi të posaçëm destinuar për UÇK-në, *Atdheu Thërret*.

³⁴ Më duket e drejtë të theksoj hetimin e shkëlqyer gazetaresk të *Balkan Insider Reporter’s Network (BIRN)*, që i kushtoi në prill 2009 një artikull elementëve të rrjetit të kampeve të burgimit të UÇK-së në Shqipëri (Altin Raxhimi, Vladimir Karaj e Michael Montgomery).

³⁵ Ndërsa Thaçi ishte i regjistruar në Universitetin e Prishtinës dhe u dallua si udhëheqësi i lëvizjes së studentëve shqiptarë të Kosovës, Muja studjoi për kardiologji në Universitetin e Tiranës dhe u bashkua me elementët më militantë të qëndresës shqiptare ndaj shtypjes serbe të Kosovës.

³⁶ Muja ishte “koordinatori mjekësor” i përgjithshëm i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, një funksion që i jepte mundësi të kontrollonte furnizimin me trajtime mjekësore destinuar për ushtarët e plagosur të UÇK-së dhe rastet e tjera urgjente në zonat operative të UÇK-së. Muja ka përdorur konkretisht spitalin ushtarak të Tiranës në Shqipëri, dhe ka administruar furnizimet dhe materialin e konsiderueshëm që UÇK-ja merrte falë dhurimeve ardhur nga jashtë. Më 1998 dhe 1999, në cilësinë e tij të përfaqësuesit zyrtar të UÇK-së, dhe i ndihmuar nga elementë të ushtrisë shqiptare dhe të shërbimeve të fshehta shqiptare, Muja administroi gjithashtu një tërësi infrastrukturash të tjera të ndryshme: një helikopter, të paktën, shumë projekte ndërtimi të financuara fuqimisht dhe pajisje banesash të improvizuara – konkretisht shtëpi dhe apartamente private – të destinuara për

të “koordinatoreve” të UÇK-së vendosur në Shqipëri³⁶, më pas, anëtar i qeverisë së përkohshme të Kosovës dhe kryekomandant i Korpusit të mbrojtjes së Kosovës (KPC)³⁷; pasi kaloi në funksionin e përgjegjës politik civil të Partisë demokratike të Kosovës (PDK), ai ushtron aktualisht funksione të rëndësishme pranë autoriteteve të sotme të Kosovës.³⁸

77. Veprimtaria e ushtruar nga Muja në sektorin mjekësor është filli drejtues i krejt funksioneve të tij. Nuk e marrim me lehtësi faktin që ai prezantohet dhe konsiderohet në shumë qarqe si “Dr Shaip Muja”, mjek e kirurg, por edhe si prakticien humanitar e përkrahës i progresit.³⁹

78. Kemi zbuluar shumë tregues konvergjentë për rolin kapital të luajtur gjatë më shumë se dhjetë vjetësh nga Muja në rrjete të tilla ndërkombëtare që janë shumë larg për t’u mburrur, si ato të trafikantëve të qenieve njerëzore, të sekserëve të akteve kirurgjikale të paligjshme dhe të aktorëve të tjerë të kriminalitetit të organizuar.

79. Këta tregues dhe elementë prove kanë bërë të dyshohet që Muja, në pjesën më të madhe falë karrierës mjekësore në dukje shembullore që vazhdonte të bënte paralelisht, ka arritur të lidhë kontakte, të fshihet prapa funksioneve të veta mbuluese dhe të gëzojë kështu një mosndëshkim të shkëlqyer për ushtrimin e veprimtarive kriminale të organizuara. Mund të vendoset këtu një analogji me mënyrën se si Thaçi dhe anëtarë të tjerë të “Grupit të Drenicës” kanë përfituar nga funksionet publike që ushtronin, shpesh në kuadrin e diplomacisë ndërkombëtare. I vetmi dallim, për Mujën, ka të bëjë me faktin që roli i tij brenda kriminalitetit të organizuar gati është i panjohur jashtë rrjeteve kriminale me të cilat ka punuar dhe nga disa hetues që i kanë ndjekur penalisht.

80. Sipas dëshmive të mblledhura pranë atyre burimeve nga tonat që kanë marrë pjesë në operacionet e UÇK-së në Shqipëri, si dhe pranë bashkëpatriotësh të tjerë të Shaip Mujës të pranishëm në gjirin e ushtrisë e të qarqeve politike, dhe që e njihnin atë nga afër, ky i fundit do ketë arritur të fitojë e të ruaj një ndikim të fshehtë në allishverishet e UÇK-së, gjatë kësaj periudhe vendimtare të fundit të viteve 90, kur ajo fitoi përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare.

81. Gjatë operacioneve luftarake që tronditën Veriun e Shqipërisë dhe zonën përgjatë kufirit të Kosovës, dhe që përkojnë me ndërhyrjen e NATO-s më 1999, Muja, ashtu si shumica e komandantëve të UÇK-së do ketë mbetur i tërhequr nga vija e frontit, duke mbajtur bazën e komandimit operativ të UÇK-së në Tiranë.

82. Muja, Haliti e Veseli do kenë kërkuar konkretisht mjete novatore për të përdorur e investuar milionat e dollarëve të “fondit të luftës” krijuar nëpërmjet dhurimeve të derdhura

komandantët, të rekrutuarit dhe forcat ndihmëse të UÇK-së që shkonin në Shqipëri që nga jashtë shtetit, përfshirë edhe ata që kalonin transit për në Kosovë.

³⁷ Muja ushtroi funksionin e dyfishtë të koordinorit për përkujdesjet mjekësore dhe shëndetin në qeverinë e përkohshme të Kosovës, nën tutelën e Kryeministrit të përkohshëm Thaçi, si dhe funksionin e komandantit të batalionit të 40 mjekësor të Korpusit të mbrojtjes së Kosovës (KPC).

³⁸ Në çastin e hartimit të këtij raporti, në dhjetor 2010, Shaip Muja ushtronte në gjirin e administratës së Hashim Thaçit funksionin e këshilltarit politik kryesor pranë kabinetit të Kryeministrit, ku ishte i ngarkuar konkretisht me portofolin e shëndetësisë.

³⁹ I njihet përgjithësisht Mujës fakti se ka ndihmuar në ngritjen e një sistemi “telemjekësie” në Kosovë, që lejon të zbatohen përkujdesje shëndetësore dhe kryerje veprimesh kirurgjikale në distancë, me ndihmën e mjekëve, duke u lidhur pjesëmarrësit falë internetit.

jashtë shtetit për kauzën e UÇK-së. Muja e Veseli do kenë arritur nga ana tjetër, të lidhin kontakte, për llogari të “Grupit të Drenicës”, me shoqëri të huaja ushtarake e të sigurimit.⁴⁰

83. Na duket interesante në mënyrë të veçantë të nxjerrim në pah se Thaçi dhe “Grupi i tij i Drenicës” kanë përfituar nga dy evolucione madhore të gjendjes pas 12 qershorit 1999.

84. Së pari, tërheqja e forcave serbe të sigurisë nga Kosova u lejoi grupëzimeve të ndryshme të UÇK-së, pra dhe “Grupit të Drenicës” të Thaçit, të marrin me të vërtetë në dorë kontrollin, pa asnjë pengesë, të një hapësire territoriale të gjerë në të cilën ata mund të kryenin trafikime dhe veprimtari të ndryshme kontrabande.

85. Pas bombardimeve të NATO-s më 1999, KFOR-i dhe UNMIK-u ishin të paaftë për të siguruar në Kosovë respektimin e ligjit dhe kontrollin e lëvizjeve të popullsisë apo kontrollin e kufijve. Fraksionet e ndryshme të UÇK-së dhe grupet disidente që kontrollonin zona të veçanta të Kosovës (fshatra, pjesë rruge, shpesh edhe disa godina) ishin në gjendje të ndërmerrnin veprimtari të kriminalitetit të organizuar praktikisht sipas dëshirës së tyre, përfshirë edhe ruajtjen e trofeve të fitores që dukej se kishin arritur mbi Serbët.

86. Së dyti, pushteti politik i përforcuar, arritur nga Thaçi (kur ai u vet-shpall Kryeministër i qeverisë së përkohshme të Kosovës), duket që i dha “Grupit të Drenicës” vendosmërinë për të eliminuar, në mënyrë sa më agresive, ata që ai i konsideronte si rivalë, tradhtarë e persona të dyshuar për “bashkëpunim” me Serbët.

87. Sipas burimeve tona, haraçi i rëndë i viktimave paguar nga popullsia shqiptare e Kosovës, në mënyrë të veçantë më 1998 dhe në fillim të 1999-ës, para dhe gjatë ndërhyrjes së NATO-s, e kishte acaruar komandën dhe militantët e UÇK-së në Shqipëri. Kur policia serbe dhe forcat paraushtarake u tërhoqën në qershor 1999, njësitë e UÇK-së të vendosura në Veri të Shqipërisë u përhapën në Kosovë me objektivin e shpallur për të “siguruar territorin”, por edhe të nxitur nga ana tjetër nga një ndjenjë e papërmbajtshme zemërimi e, le ta themi hapur, hakmarrjeje ndaj të gjithë atyre që dyshoheshin prej tyre se kishin marrë pjesë në shtypjen e popullsisë të etnisë shqiptare.

88. Banorët serbë të lokaliteteve me shumicë shqiptare shpejt u bënë pika e shënjestrës së reprezaljeve, në po atë shkallë sa çdo person i dyshuar – qoftë edhe nisur nga akuza pa bazë, të lëshuara nga anëtarët e një klani kundërshtar apo në kuadrin e një gjakmarrjeje të vjetër – se kishte “bashkëpunuar” me administratën serbe apo kishte punuar për llogari të saj. Trupat e UÇK-së morën urdhër të hartonin, në kuadër të një fushate frikësimi duke shkuar derë më derë, listën e emrave të atyre që kishin punuar për autoritetet e përjashtuara të ish Jugosllavisë (pavarësisht se çfarë funksioni administrativ kishin kryer) ose kur prindërit apo partnerët e tyre kishin ushtruar funksione të tilla. Një numër i madh anëtarësh të etnisë shqiptare, si dhe minoritarë rom e të tjerë u klasifikuan në këtë mënyrë në kategorinë e këtyre “bashkëpunëtorëve” të hamendësuar.

89. Nisur nga këto elemente, arritëm në konkluzionin se dhunimet e kryera nga anëtarët dhe simpatizantët e UÇK-së në Shqipëri shkojnë përtej marrëzive të thjeshta që do kenë qenë

⁴⁰ Ndikimi i përbashkët i Mujës e Veselit në këtë fushë ka zgjatur gjatë gjithë fazës së tranzicionit të Korpusit të mbrojtjes së Kosovës: të dy personat do kenë luajtur një rol qendror në konceptimin e strukturave informative dhe të mekanizmave të marrjes së vendimeve strategjike në gjirin e PDK-së. Ndër kontribuesit e jashtëm të shërbimeve që duhet t'i kenë ndihmuar figurojnë, sipas disa të dhënave, anëtarët e shërbimeve të fshehta shqiptare, të shoqërive amerikane të sigurimit dhe ushtarakë privatë.

vepër individësh jashtë ligji apo rebelësh të ndonjë force luftarake për më tepër të disiplinuar. Ne mendojmë në të kundërt se këto dhunime ishin të përgjithësuara në mënyrë aq të mjaftueshme, sa korrespondojnë me një mënyrë veprimi sistematik.

90. Pavarësisht nga disa akte që dëshmojnë për egërsinë apo përbuzjen e veçantë që kanë treguar autorët e tyre ndaj viktimave, ne kemi vënë re se, në mënyrë të përgjithshme, këto dhunime, me sa duket kanë qenë të koordinuara e të mbuluara nga një strategji globale, e paramenduar dhe evolutive, vendosur nga drejtues të “Grupit të Drenicës”.

91. Në tërësi, këto dhunime janë simptomatike për rolin e dorës së parë që ka luajtur kriminaliteti i organizuar në gjirin e tarafit të brendshëm sundues të UÇK-së. Të mbaje persona të kapur në vende burgimi të improvizuara, jashtë njohjes apo dijenisë së çdo autoriteti, dhe të detyroje me heshtje çdo person që kishte mësuar natyrën e vërtetë të veprimtarive të paligjshme të rojtarëve të burgjeve, kjo bën pjesë në metodologjinë më se të njohur të pjesës më të madhe të strukturave mafioze – dhe “Grupi i Drenicës” nuk ishte aspak i ndryshëm.

92. Vetë “Grupi i Drenicës” me sa duket ka njohur evolucion: nëse më parë ka qenë pjesë e një force të armatosur – UÇK-së, e angazhuar haptas në luftën për çlirim, më pas, do jetë shndërruar në një bandë e mbifuqishme ndërmarrësish kriminelë (duke synuar marrjen e kontrollit të shtetit të ardhshëm). Paralelisht, kemi zbuluar gjithashtu një transformim të veprimtarive të anëtarëve të Grupit në një fushë të veçantë: Vendet e burgimit dhe trajtimi çnjerëzor i robërve.

3.3. Vendet e burgimit dhe trajtimi çnjerëzor i robërve

93. Gjatë kërkimeve tona, kemi regjistruar gjashtë pika të veçanta të paktën në territorin shqiptar, të ndodhura në një zonë që shtrihet nga Cahani rrëzë Malit Pashtrik, në pjesën më veriore të Shqipërisë, gjer në rrugën bregdetare të Durrësit, përgjatë bregdetit mesdhetar të Shqipërisë perëndimore.

94. UÇK-ja sigurisht nuk ka pasur zotërimin e plotë dhe të vazhdueshëm të këtij territori gjatë periudhës që na intereson, por kjo vlen gjithashtu për cilindo shërbim apo entitet tjetër që s’kish pse të mos donte apo të mos ish në gjendje të vepronte për të respektuar aty ligjin.

95. Kjo mungesë ruajtjeje e rendit publik dëshmonte nga ana tjetër për paaftësinë e policisë dhe të shërbimeve informative shqiptare për shtypjen e banditizmit mafioz, të organizuar e të ushqyer nga disa njësi të UÇK-së që ishin vendosur në Veri dhe në Qendër të Shqipërisë, dhe për dhënien fund të mosndëshkimit të tyre. Udhëheqësit rajonalë të UÇK-së vepronin në fakt në mënyrë të tillë që të sundonte ligji i tyre në zonën përkatëse që kishin vendosur nën kontroll.

96. Vendet e burgimit – për të cilat morëm dëshmi të drejtpërdrejta nga burimet tona, të mbështetura nga elemente të mbledhura prej gazetarësh investigues (disa datojnë që prej dhjetë vjetësh a më shumë), dhe më pranë në kohë, të mbështetura nga përpjekjet e hetuesve dhe prokurorëve të EULEX-it – përfshijnë: Cahani, Kukës (rrethina), Bicaj, Burrel, Rripe (fshat në jug-perëndim të Burrelit në rrethin e Matit), Durrës, dhe ndoshta më i rëndësishmi nga të gjithë në kuadrin e mandatit tonë të veçantë, Fushë-Kruja.

97. Gjatë kërkimeve tona, arritëm të shkojmë në zonën e dy prej këtyre qendrave të UÇK-së ngritur në Shqipëri, por pa mundur të depërtojmë brenda tyre. Po ashtu, për katër qendra të tjera të paktën, për të cilat jemi në dijeni të ekzistencës së tyre, morëm drejtpërdrejt dëshmi nga shumë persona që, siç e vërtetuam, kishin qenë personalisht në njërin prej tyre, madje edhe në shumë prej tyre, qoftë kur ishin përdorur nga UÇK-ja, qoftë me rastin e misioneve të kontrollit të kryera që atëherë.

98. Përdorimi i këtyre qendrave nuk bëhej në mënyrë të pavarur apo autonome: ato ishin, të themi, një komponent i të njëjtit rrjet të koordinuar, vendosur nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e disa komandantëve të lartë të UÇK-së. Emëruesi i përbashkët i tërë këtyre qendrave ishte fakti se në to mbaheshin civilë, në territor shqiptar, në duart e anëtarëve dhe simpatizantëve të UÇK-së.

99. Harta grafike që përfshihet në këtë raport tregon vendet ku, sipas informatave tona, ekzistonin qendra burgimi, si dhe rrugët e transportit që i lidhnin.

100. Megjithatë, kishte dallime të mëdha për sa i përket periudhës dhe objektivave për përdorimin e secilës prej këtyre qendrave të burgimit. Është e qartë se çdo pikë burgimi kishte “profilin e vet veprues”, në raport konkretisht me mënyrën se si krijoheshin lidhjet për të bërë të mundur: realizimin e ruajtjes në burgim dhe të veprimtarive shtojcë; karakterin dhe përbërjen e grupeve të robërve; modalitetet për dërgim të robërve; dhe fatin që i priste robërit gjatë dhe pas periudhave përkatëse të ruajtjes.

101. Po e fillojmë me një përshkrim të përgjithshëm të burgimeve nga UÇK-ja në kohë lufte (disa prej tyre me sa duket e kanë kaluar pragun e krimeve të luftës), dhe të burgimeve pas përfundimit të konfliktit nga anëtarët dhe simpatizantët e UÇK-së (që me sa duket përbëjnë veprimtari të sferës së krimit të organizuar). Më pas, do të shqyrtojmë më nga afër çka ndodhi në secilën nga pikat e burgimit të ngritura në territorin shqiptar.

3.3.1. Burgime nga UÇK-ja në kohë lufte – Kategoria e parë e robërve: “robërit e luftës”

102. Në muajt prill-qershor 1999, burgime personash nga UÇK-ja në territor shqiptar bazoheshin dukshëm, sipas protagonistëve, në domosdoshmëritë strategjike të luftimit të një gueriljeje të caktuar.

103. Gjatë luftës dhe periudhës së lëvizjeve masive të refugjatëve drejt Shqipërisë, politika e ndjekur nga UÇK-ja do jetë prirë drejt “marrjes në pyetje” të çdo personi të dyshuar se mund të kishte në çfarëdolloj mënyre njohuri për veprimet e autoriteteve serbe dhe konkretisht të gjitha atyre që dyshoheshin se ishin “bashkëpunëtorë”.

104. Kjo politikë do jetë zbatuar me forcë në territor shqiptar nga elementë të fuqishëm të shërbimeve informative kombëtare, midis të cilëve SHIK (i shndërruar në SHISH) dhe nga shërbimet informative të ushtrisë, disa anëtarë të së cilës do kenë marrë pjesë madje edhe gjatë marrjes në pyetje. Frymëzuesi kryesor i kësaj politike duhet të ketë qenë Kadri Veseli (alias Luli), një personazh-kyç i “Grupit të Drenicës”.

105. Vendet e burgimit ku do kenë ndodhur këto “marrje në pyetje” – konkretisht ato më pranë kufirit me Kosovën – ishin njëkohësisht “baza” apo “kampe” ushtarake – vende stërvitjeje nga ku dërgoheshin në front luftëtarë apo furnizoheshin me armë e municione.

Bëhej fjalë për prona tregtare me destinacion të ndryshuar apo të përvetësuara për këtë qëllim (përfshirë edhe një hotel e një uzinë) në qytete të rëndësishme provinciale apo në rrethinat e tyre, të vëna në dispozicion të UÇK-së, kryesisht nga simpatizantë shqiptarë që mbështesnin kauzën patriotike.

106. Disa nga këto kampe të kohës së luftës shërbenin njëkohësisht si vende burgimi, por edhe për qëllime të tjera, si për grumbullim mjetesh, për fshehje materiali ushtarak të rëndë, për depozitim materiali logjistik apo furnizime, si uniforma e armë zjarri, për riparime mjetesh të dëmtuara, apo për mjekime ushtarësh të plagosur, madje edhe si pikëtakimi për komandantët e ndryshëm të UÇK-së.

107. Veçse, në shumicën e rasteve, robërit do jenë mbajtur mënjanë operacioneve që mund të klasifikohen si klasike në kohë lufte, dhe nga ana tjetër shumë larg syve të shumicës së luftëtarëve të UÇK-së e të vëzhguesve të jashtëm që mund të kenë vizituar këto baza.

108. Duke filluar nga çasti kur tërë robërit e transportuar në Shqipëri nga UÇK-ja shpërndaheshin në kategori të ndryshme brenda grupit të përgjithshëm të robërve ku bënin pjesë, dhe kjo në funksion të fatit që i priste, kemi shumë të drejtë të mendojmë se kategoria më e vogël numerikisht ishte ajo e “robërve të luftës”: ata që mbaheshin të izoluar vetëm për periudhën e konfliktit në Kosovë, nga të cilët disa arritën të arratiseshin nga Shqipëria apo u liruan, u kthyen në vatrat e tyre gjallë e shëndoshë dhe vazhdojnë të jenë edhe sot në jetë.

109. Jemi vënë në dijeni të ekzistencës së personave “të mbijetuar” të kësaj kategorie, që më pas dëshmuar për krimet e bëra nga komandantët të ndryshëm të UÇK-së, në tre vendet e mëposhtme të burgimit:

- Cahan: kamp i UÇK-së që ndodhet pranë vijës së frontit të Kosovës, dhe që ka shërbyer gjithashtu si kamp bazë për përhapjen e trupave;
- Kukës: ish uzina metalurgjike e shndërruar në qendër të UÇK-së, e destinuar për përdorime të ndryshme dhe që përmban të paktën dy “kazerma qelish” për ruajtjen e robërve;
- Durrës: vendi i marrjes në pyetje nga UÇK-ja, që ndodhet nga pas hotelit Drenica, shtatmadhuria dhe qendra e rekrutimit të UÇK-së.

110. Sipas dëshmive të drejtpërdrejta, të mbështetura nga elementët e akt-akuzave të ngritura nga Hetuesia e posaçme e Republikës së Kosovës, e vlerësojmë të paktën në 40 persona numrin e përgjithshëm të robërve të burgosur nga UÇK-ja në një a më shumë nga tre vendet e mësipërme të burgimit⁴¹ dhe që kanë mbijetuar deri më sot.

111. Ky nëngrup përfshinte kryesisht civilë që i përkisnin etnisë shqiptare, si dhe rekrutë të UÇK-së të dyshuar se ishin “bashkëpunëtorë” apo tradhtarë, akuzuar për spiunazh në përfitim të Serbëve apo se kishin mbështetur a bërë pjesë tek kundërshtarët politikë e ushtarakë të UÇK-së, konkretisht LDK-ja dhe Forcat e reja të armatosura të Republikës së Kosovës (FARK).⁴²

⁴¹ Kjo shifër prej 40 personash nuk përfshin ata që janë mbajtur për një kohë tepër të shkurtër në Durrës, kur vetëm janë marrë në pyetje nga agjentë të shërbimeve informative të UÇK-së.

⁴² Grupi ushtarak i pagëzuar *Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës*, apo FARK, luftonte zyrtarisht për çlirimin e Kosovës ashtu sikurse UÇK-ja, por komandantët e kësaj të fundit e trajtonin me përbuzje e dyshim, si

112. Personat që përbënin këtë nëngrup ishin të destinuar kryesisht për t'iu nënshtruar një hetimi; shumë prej tyre kanë vënë në dukje se kanë qenë marrë në pyetje në mënyrë të egër nga agjentë të shërbimeve informative shqiptare e të UÇK-së. Gjatë periudhës së mbajtjes në izolim që pasonte hetimin dhe që mund të zgjaste nga disa ditë deri në mbi një muaj, shumica e këtyre robërve rriheshin nga rojet ose keqtrajtoheshin pa asnjë shkak, në kuadrin e masave që duket se kishin për qëllim t'i ndëshkonin, t'i frikësonin e t'i terrorizonin.

113. Sabit Geqi, Riza Alija (alias “komandant Hoxhaj”) dhe Xhemshit Krasniqi figurojnë ndër komandantët e UÇK-së të akuzuar se kanë qenë në krye të këtyre qendrave të burgimit. Këta tre persona zënë një vend të rangut të parë edhe në hetimet e mëparshme çelur nga UNMIK-u lidhur me krimet e luftës të kryera në Veri të Shqipërisë; tashmë po i nënshtrohen një hetimi nga ana e Hetuesisë së posaçme të Kosovës dhe së shpejti duhet të gjykohen nga gjykata e shkallës së parë të Kosovës⁴³; pasuritë e tyre të patundshme janë bllokuar plotësisht.

114. Elementët e provës të mbledhur me rastin e këtyre procedurave duket që tregojnë se këta veprimtarë të UÇK-së si dhe komandanti i tyre rajonal i Veriut të Shqipërisë, Xheladin Gashi, sot i vdekur, ishin të afërt të “Grupit të Drenicës” drejtuar nga Hashim Thaçi dhe vepronin konkretisht së bashku me Kadri Veselin.

3.3.1.1. Karakteri i qendrave të burgimit: Cahan

115. Kampi i Cahanit ishte më veriori i qendrave të burgimit vendosur në Shqipëri nga UÇK-ja; ishte rrjedhimisht më ngushtë i lidhur me aktivitetet e vijës së frontit.⁴⁴ Nuk gjetëm asnjë shenjë të transportimit të robërve nga Cahani drejt qendrash të tjera burgimi që ndodheshin në Shqipëri, edhe pse kjo mundësi nuk mund të përjashtohet.

116. Duket se sa më thellë drejt territorit shqiptar ndodhej një vend burgimi, aq më pak ai ishte drejtpërdrejt i lidhur me përpjekjen për luftë të UÇK-së, dhe aq më shumë ishte i lidhur me qarkun e kriminalitetit të organizuar.

117. Personat që kanë treguar se janë mbajtur të izoluar dhe janë keqtrajtuar në Cahan, me sa duket, janë kapur kryesisht në mënyrë arbitrare dhe relativisht spontane, shpesh gjatë

një kundërshtar. FARK-ët, politikisht të përafërt me LDK-në, konsideroheshin si krahu i armatosur i qeverisë në mërgim të Bujar Bukoshit. Në të kundërt të UÇK-së, FARK-ët u formuan nisur nga një bërthamë oficerësh me përvojë të dalë nga etnia shqiptare dhe që kishin shërbyer në Ushtrinë federale jugosllave. Komandantët e UÇK-së i shihnin me shumë dyshim FARK-ët dhe përiqeshin t'i pengonin në rekrutimin e luftëtarëve të rinj dhe në furnizimin me armë e municion. UÇK-ja ka mbajtur të burgosur shumë persona, sidomos civilë me origjinë nga Kosova, në Veri të Shqipërisë, pranë kufirit me Kosovën, persona që ajo i akuzonte se mbshtesnin FARK-ët dhe se nuk tregoheshin të ndershëm ndaj kauzës së UÇK-së.

⁴³ Geqi e Alija janë arrestuar përkatësisht në maj e qershor 2010, dhe akuzuar për krime lufte ndaj popullsisë civile. Megjithë provat e mjaftueshme të mbledhura kundër të dyshuarit të tretë, Krasniqi, ky vazhdonte të ishte në arrati deri në çastin e hartimit të këtij raporti dhe nuk mund të vihej nën akuzë në kuadrin e procedurës penale kosovare. Duke pritur arrestimin e Krasniqit dhe administrimin e efektshëm të drejtësisë, procesi ndaj të tre personave duhej të ishte kryer para gjykatës së shkallës së parë të Prishtinës e të Mitrovicës në fillim të 2011.

⁴⁴ Burimet që disponojmë nga brenda UÇK-së na kanë vënë në dukje se Cahani ishte në fakt një kamp etape, ku UÇK-ja bënte ndalesë gjatë përparimit të saj përmes kufirit malor të Kosovës. Luftëtarët e UÇK-së të stacionuar në Cahan njihen për shpërthimin e “Operacionit Aero”, një mësymje e jashtëzakontë në territorin serb në fund të majit 1999.

patrullimeve të kryera nga UÇK-ja në afërsi të vetë kampit ose pranë postesh kontrolli të ndryshme, vendosur në pikat e kalimit të kufirit midis Kosovës e Shqipërisë.

118. Personat që përbëjnë këtë nëngrup të parë, me sa duket janë liruar në pjesën më të madhe të tyre kur luftimet përfunduan në front dhe kur forcat serbe të sigurisë u tërhoqën nga pozicionet që zinin në Kosovë në qershor 1999. Mbijetesa e një numri të madh të këtyre robërve vërtetohet konkretisht nga një listë me mbi 12 persona të përcaktuar e cilësuar si “viktima/dëshmitarë” në procedurën penale të nisur kundër komandantëve të kampeve të Cahanit e Kukësit.

3.3.1.2. Karakteri i qendrave të burgimit: Kukës

119. Ndër qendrat konkrete të burgimit të fshehtë të civilëve nga UÇK-ja, kemi marrë të dhëna të plota për një bazë të vendosur në godinat e një uzine të transformuar, që ndodhet në periferi të qytetit të Kukësit, në Veri të Shqipërisë.

120. Dy dëshmitarë të drejtpërdrejtë na kanë shpjeguar se si transportoheshin robërit në pikën e Kukësit dhe se si rraseshin në qeli të improvizuara e të pista, pa ujë, pa ushqim. Aty, rregullisht do t’u jenë nënshtruar marrjes në pyetje në mënyrë të egër nga ana e ushtarëve të UÇK-së, duke pësuar goditje pa hesap prej tyre.

121. Përmasa e keqtrajtimit që pësonin robërit e kësaj qendre është pasqyruar me imtësi konkretisht nga veprimtarët kosovarë dhe ndërkombëtarë të shërbimeve të Hetuesisë së posaçme të Kosovës. Hetuesi ka mbledhur më 2009 dhe 2010 deponimet e mbi 10 personave, praktikisht të gjithë nga etnia shqiptare, që kanë treguar se janë mbajtur të burgosur gjatë një periudhe të pacaktuar, se janë goditur me shkopinj gome dhe objekte të tjera dhe se kanë pësuar forma të ndryshme keqtrajtimi çnjerëzor në pikën e Kukësit. Shumë dëshmitarë kanë deklaruar se dëgjonin në korridore britmat e agonisë të personave të izoluar larg qelave të tjera.

122. Qeveria shqiptare është shprehur se asnjë trup njeriu vvarë gjatë konflikti të Kosovës nuk është varrosur në territor shqiptar dhe se asnjëherë nuk ka pasur rast të tillë. Rasti i Kukësit tregon karakterin krejt të pasaktë të këtij pohimi.

123. Së pari, trupa të vërvitur në lumenjtë e Kosovës janë çuar nga rryma drejt kufirit shqiptar. Zbulimi i këtyre trupave dhe tërheqja e kufomave nga përfaqësuesit e OMPF-së në Kosovë nuk ka pse të shkaktojë polemikë; por autoritetet shqiptare deri më sot kundërshtojnë kategorikisht çdo ndërhyrje në këto çështje.

124. Së dyti, ka dalë qartë tashmë se në disa raste të përcaktuara e të njohura, trupa Kosovarësh të vvarë janë varrosur në Shqipëri. Këto çështje kanë çuar – në raste të vërtetuara nga gazetarë shqiptarë e ndërkombëtarë, për të cilat jemi në dijeni – në bisedime të gjata por të matura midis familjeve të këtyre Kosovarëve dhe autoriteteve të ngarkuara për administrimin e kësaj varreze (këtyre varrezave) në Shqipëri. Është për t’u vënë në dukje në fund të fundit se në një rast që na është shpjeguar me hollësi nga një prej burimeve tona të drejtpërdrejta, trupat janë zhvarrosur dhe riatdhesuar në Kosovë për t’u varrosur sipas të gjitha rregullave nga familjet. Autoritetet shqiptare na kanë thënë se ato nuk kishin dijeni për çështje të kësaj natyre.

125. Së treti, disa pohime përmendin ekzistencën e varreve masive në territorin shqiptar. Shërbimet e hetuesisë serbe të ngarkuara për krime lufte na kanë deklaruar se zotëronin fotografi të marra me satelit të zonave në të cilat ndodheshin këto varre; por vetë varret ende nuk janë gjetur gjer më sot, me gjithë kërkesën zyrtare për të bërë kërkime paraqitur nga autoritetet serbe pranë autoriteteve shqiptare.

126. Kemi marrë regjistrat e varrezës së Kukësit, që duket se japin një konfirmim të rëndësishëm për këtë çështje: trupat e personave me origjinë nga Kosova janë varrosur më së miri në Veri të Shqipërisë. Dokumenti më i rëndësishëm ishte një “listë imigrantësh të vdekur të Kosovës, 28 mars 1999 - 17 qershor 1999” prej pesë faqesh, e hartuar nga kontrollori i shërbimeve publike të komunës së Kukësit në Veri të Shqipërisë.

127. Ky dokument, më pas u kalua në dosje si element prove nga gjykata e instancës së parë të Mitrovicës, në Kosovë, paraqitur nga Hetuesia e posaçme e Kosovës. Doli se një nga personat e vdekur që figurojnë në këtë listë – Anton Bisaku, n°138 – bënte pjesë ndër viktimat e njohura të burgimeve të fshehta dhe të trajtimeve çnjerëzore të qendrës së UÇK-së në Kukës të Shqipërisë.

128. Sipas një akt-akuze të hartuar në gusht 2010, Bisaku dhe një numër jo i përcaktuar civilësh të tjerë të burgosur në Kukës “janë rrahur e goditur shumë herë me radhë me shkopinj gome e me dru, me shkelma, si dhe janë sharë e torturuar”. Në akt-akuzën drejtuar ndaj të pandehurit Sabit Geci “për krime lufte të kryera ndaj popullsisë civile” dhe “për vrasjen e një civili në Kukës, Anton Bisakut, të dërmuar nën goditjet dhe të ekzekutuar”, prokurori i posaçëm i EULEX-it saktësoi se Bisaku ishte “vrrarë me plumba, me një armë zjarri drejtuar mbi të, ndërkohë që ishte objekt keqtrajtimesh, goditjesh e aktesh torture të kryera më 4 qershor ose rreth 4 qershorit 1999”.

3.3.2. Burgime nga anëtarë dhe simpatizantë të UÇK-së pas përfundimit të konfliktit

129. Pas 12 qershorit 1999, Kosovarë shqiptarë vazhduan të mbajnë persona të burgosur për motive të ndryshme, ku futen dëshira për hakmarrje, ndëshkimi dhe lakmia për fitime. Autorët, të gjithë anëtarë dhe simpatizantë të UÇK-së, sipas burimeve tona, zhvilluan mënyra të reja për të kapur dhe për të përfituar nga civilë, duke i transportuar jashtë Kosovës, drejt vendesh të reja burgimi në Shqipëri, të ndryshme nga ato ku operonte UÇK-ja në kohë lufte.

130. Në muajt që pasuan menjëherë shpalljen e mbarimit të konfliktit në Kosovë në qershor 1999, anëtarë dhe simpatizantë të UÇK-së do kenë mbajtur në burgim të fshehtë në territorin shqiptar një numër të madh personash të rrëmbyer.

131. Është jashtëzakonisht shqetësuese për ne që vazhdojmë të jemi pa asnjë lajm për shumicën dërrmuese të personave për të cilët kemi mundur të përcaktojmë se kanë qenë trajtuar në këtë mënyrë, ndër të cilët figurojnë shumë anëtarë të etnisë shqiptare; çelja e një hetimi për këtë çështje dhe zgjidhja e saj nga autoritetet shqiptare duhet të jenë një detyrë parësore.

132. Sipas informatave që kemi, nuk ekzistonte në Shqipëri një strukturë unike për këto burgime sekrete pas konfliktit, por një rrjet ad hoc i plotë instalimesh të këtij lloji, të lidhur me njëri-tjetrin nëpërmjet komunikimesh të mbikëqyrura nga patrulla që kryenin shpesh kalimet nga njëri vend në tjetrin përmes rrugëve shqiptare dhe përmes kufirit të depërtueshëm

e kaotik (sidomos në çastin e zhvendosjeve masive të refugjatëve në mesin e viti 1999) midis Kosovës e Shqipërisë.

133. Kemi marrë kështu dëshminë e drejtpërdrejtë, mbështetur edhe prej elementëve të tjerë, se luftëtarë e simpatizantë të UÇK-së kanë kryer transportime të shumta drejt e ndërmjet qendrave të përmendura në këtë raport dhe kanë transportuar po ashtu robër nga shumica e këtyre vendndodhjeve.

134. Gjatë këtyre udhëtimeve, të rekrutuarit dhe përkrahësi e tyre të UÇK-së do jenë zhvendosur nga një qendër në tjetrën shpesh në karvan, me mjete private, pa targa, konkretisht kamionë e furgona. Do kenë transportuar kështu personelin dhe materialin logjistik të UÇK-së, furnizime ushqimore, alkool apo cigare si dhe grupe grash të destinuara për shfrytëzim seksual. Sidomos, duke filluar nga korriku 1999 e gjer në gusht 2000, ata do kenë transportuar robër.

135. Vendet e burgimit të periudhës pas konfliktit dallohen nga vendet e përdorura në kohë lufte: kemi gjetur se bëhet fjalë në radhë të parë për banesa fshati në zonat fshatare apo përreth-urbane, përfshirë edhe ferma shqiptare tradicionale me godinat e tyre shtojcë.

136. Kishte gjithashtu të paktën një strukturë të ndërtuar për qëllime të posaçme në gjirin e rrjetit të vendeve të burgimit të pas-konfliktit, e vetme për sa i përket pamjes dhe përdorimit të saj. Ishte një qendër pritëse e fjalës së fundit për krimin e organizuar të trafikut të organeve. Kjo strukturë shfaqej si një klinikë kirurgjikale e improvizuar, dhe ishte vendi ku disa persona të burgosur nga anëtarët dhe simpatizantët e UÇK-së do kenë pësuar heqje të veshkave të tyre nëpërmjet detyrimit. Sipas burimeve tona, organizatorët e kësaj ndërmarrjeje kriminale do t'i kenë transportuar më pas organet njerëzore jashtë Shqipërisë për t'ua shitur klinikave private të huaja që bëjnë pjesë në rrjetin e "tregut të zi" ndërkombëtar të trafikut të organeve për qëllime transplantimi.

3.3.2.1. Kategoria e dytë e robërve: "të zhdukurit"

137. Robërit e kësaj kategorie të dytë kanë qenë viktima zhdukjeje të detyruar: asnjë prej tyre nuk është parë as sinjalizuar dhe askush nuk ka dëgjuar të flitet për ta qëkurse janë rrëmbyer nga Kosova në javët dhe muajt që pasuan menjëherë 12 qershorin 1999.

138. Ata që orkestruan këtë ndërmarrje kriminale do kenë ngritur në këmbë një sistem "shoshitës" në bazë të të cilit një numër i vogël personash të përzgjedhur nga çdo grup më i madh robëresh përcillej në një vend tjetër. Të dhënat e mbledhura të bëjnë të mendosh se kjo procedurë shoshitjeje e robërve duhej të shërbente për të përcaktuar aftësinë e personave të zgjedhur për përdorimin për të cilin destinoheshin.

139. Ndër faktorët e gjykuar vendimtarë në këtë proces shoshitës, siç na e përsëritën shumë nga burimet tona, figurojnë mosha, seksi, gjendja shëndetësore dhe në fakt, origjina etnike e robërve, ku piketoheshin në radhë të parë Serbët.

140. Na kanë sinjalizuar shumë herë se robërit jo thjesht transferoheshin, por ata edhe "bliheshin" e "shiteshin" gjithashtu. Në bazë të këtyre treguesve, u përpoqëm të përcaktojmë degëzimet midis, nga njëra anë, rrëmbimeve dhe burgimeve jo të deklaruara të kryera në kuadrin e konfliktit dhe, nga ana tjetër, veprimtarisë së kriminalitetit të organizuar, që luante

në atë kohë, dhe vazhdon me sa duket të luajë, një rol domethënës në shumë sektorë të jetës së përditshme të rajonit.

3.3.2.1.1. Karakteri i qendrave të burgimit: Rripe

141. Gjatë kërkimeve tona, kemi përcaktuar se të paktën tri burime, prej të cilave kemi marrë dëshmitë, kanë qenë, padyshim, fizikisht të pranishëm në shtëpinë e familjes K. në Rripe (“Shtëpia e Verdhë”) pranë Burrelit, në kuadrin e akteve kriminale të kryera nga UÇK-ja, ku kanë qenë të pranishëm.

142. Secila nga këto burime ka qenë në gjendje të japë të dhëna të panjohura e të veçanta mbi vendndodhjen dhe pamjen e saktë të kësaj shtëpie, karakteristikat e pronarit të saj, njerëzit e UÇK-së që ishin të caktuar, si dhe të dhëna rreth natyrës dhe përgjegjësit hierarkikë të veprimtarive të jashtëligjshme të kryera në këtë vend nga 1999 në 2000.

143. Mbi bazën e dëshmive të këtyre burimeve, mund të arrijmë në përfundimin se shtëpia e familjes K. ka qenë pushtuar dhe vendosur nën autoritetin e UÇK-së, që ishte pjesë e një rrjeti aktiv në gati krejt gjysmën veriore të Shqipërisë.

144. Një grup i vogël oficerësh të lartë të UÇK-së do kenë drejtuar e mbikëqyrur dërgime të shumta robërish civilë në shtëpinë K. gjatë një periudhe prej gati një viti, nga korriku 1999 deri në mesin e vitit 2000. Shumica e këtyre robërve do jenë rrëmbyer në provincat jugore të Kosovës dhe dërguar në Shqipëri sipas modaliteteve transportuese tashmë të parashtruara. Ndryshe nga robërit e Kukësit, ata të Rripes i përkisnin kryesisht etnisë serbe.

145. Sipas disa burimeve të përafërta të UÇK-së, del nga ana tjetër se një numër i madh grash e vajzash, viktime të trafikimit të qenieve njerëzore janë çuar në shtëpinë e familjes K. ku kanë qenë objekt i një shfrytëzimi seksual si nga ana e anëtarëve të UÇK-së ashtu dhe nga disa njerëz të komunës së Rripes.

146. Gjatë periudhës kur UÇK-ja ka shfrytëzuar shtëpinë K., heshtja e banorëve të Rripes lidhur me praninë e njërive të UÇK-së dhe veprimtarinë e tyre do jetë arritur si nëpërmjet kërcënimit ashtu dhe nëpërmjet shpërblimeve materiale, konkretisht në formën e shumave të mëdha parash, konsumim falas të alkoolit, drogës apo prostitutave.

147. Prova të mjaftueshme tregojnë se një numër i vogël robërish të rrëmbyer nga UÇK-ja, disa prej të cilëve me etni serbe, kanë gjetur vdekjen në Rripe, në shtëpinë K. apo në afërsi të saj. Këto vdekje na janë sinjalizuar jo vetëm nga dëshmitë e ish ushtarëve të UÇK-së që do kenë marrë pjesë në ruajtjen dhe transportimin e robërve ende në jetë, por edhe falë dëshmive të personave që kanë asistuar në mënyrë të pavarur në varrimin, çvarrimin, transportin dhe varrimin e ri të trupave të robërve, si gjatë kohës kur UÇK-ja mbante të pushtuar shtëpinë K., ashtu dhe pas ikjes së UÇK-së dhe kthimit në të të familjes që banonte më parë.

148. Konstatimet tona lidhur me shtëpinë K. me sa duket mbështesin, në një masë të gjerë, konkluzionet në të cilat ka arritur një ekip gazetarësh investigues që punojnë për llogari të shoqërisë së prodhimit të dokumentarëve “American Radio Works”. Këto konkluzione janë përmbledhur në një shënim të brendshëm konfidencial dorëzuar UNMIK-ut më 2003, që u bë shkak për dërgimin e misionit hetimor në shtëpinë e familjes K. që përmendem sa më sipër.

149. Por dëshmitë që ne kemi mbledhur kanë nxjerrë në pah edhe një përmasë tjetër të operacioneve të kryera nga UÇK-ja në shtëpinë K., që nuk ka qenë e përmendur deri më sot as nga ekipi i “American Radio Works”, as nga memuarët e ish kryeprokurores së GJPNIJ, Carla del Ponte, as edhe gjatë “zbulimeve” mediatike të njëpasnjëshme.

150. UÇK-ja në fakt, nuk u mjaftua vetëm me dërgim robërisht në Rripe; ajo do ketë transportuar po ashtu disa robër të Rripes drejt qendrash të tjera ruajtjeje. Sipas dëshmimeve të mbledhura tek shoferë të ngarkuar për transportin e robërve, disa persona të ngarkuar në Rripe kanë qenë transportuar tashmë nën përkujdesjen e tyre që nga Kosova, ndërsa të tjerë robër të Rripes përcilleshin drejt një vendi tjetër, të panjohur nga shoferët dhe që ata nuk kishin arritur t’i përcaktonin.

151. Shtëpia K., rrjedhimisht, nuk përfaqësonte një pikë përfundimi, as një destinacion përfundimtar në rrjetin e transportimit të robërve e të qendrave të burgimit të lidhura njëra me tjetrën. Roli i saktë i kësaj shtëpie dhe rëndësia që ajo kishte në tërësinë e operacioneve ndoshta ka qenë vlerësuar keq gjer më sot.

152. Shtëpia K. duket në realitet se, edhe më shumë, ka qenë një vend “etape ndërmjetëse”, ku robërit në transit mbaheshin duke pritur të përcilleshin për në drejtimin e tyre përfundimtar dhe ku, sipas disa burimeve, ata i nënshtroheshin formave të “trajtimit” apo të “shoshitjes”, në dukje të çuditshme, dhe konkretisht testeve të gjakut apo ekzaminimeve shëndetësore.

3.3.2.1.2. Hetime rreth kushteve të burgimit dhe transportit

153. Robërit do jenë mbajtur të burgosur në fshehtësi në këto qendra, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të rojeve të armatosura, qoftë nëpër dhomat e godinave kryesore, qoftë në hangare, garazhe, depo apo edhe pika të tjera depozitimi.

154. Gjatë transportit të tyre nga një qendër në tjetrën, robërit zakonisht duhet të jenë rrasur në furgona e kamionë, me duart e lidhura nga pas kurrizit dhe të mbërthyer në elementë të palëvizshëm brenda mjetit.

155. Shoferët e furgonave dhe kamionëve – shumë prej të cilëve u bënë dëshmitarë kapitalë për llojet e dhunimeve të treguara – kanë parë e dëgjuar robër duke vuajtur mjaft gjatë këtyre transportimeve, konkretisht për shkak të mungesës së ajrit në pjesën e brendshme të mjetit ku ndodheshin, ose pastaj, si pasojë e vuajtjeve psikologjike tek shihnin ku po i vërviste fati që i priste, në bazë të hamendësive që bënin.

3.3.2.2. Kategoria e tretë e robërve: “viktimat e kriminalitetit të organizuar”

156. Nëngrupi që tërheq më shumë vëmendjen tonë, konkretisht sepse fati i tij ka përbërë objektin e një buje shumë të madhe dhe përgjithësisht është kuptuar keq, ka të bëjë me robërit që ne i konsiderojmë si “viktima të kriminalitetit të organizuar. Ne mendojmë se një grup prej tyre janë çuar në qendër të Shqipërisë për t’u vrarë para se t’u jenë hequr veshkat e tyre në një klinikë të sajuar.

157. Robërit e kësaj kategorie kanë pësuar në mënyrë të pamohueshme një torturë të tmerrshme në duart e gardianëve të tyre të UÇK-së. Sipas dëshmimeve të drejtpërdrejta, robërit e përfshirë në këtë nëngrup të fundit pas një “përzgjedhjeje”, mbaheshin në jetë në një etapë të parë, ushqeheshin mirë, lejoheshin të flinin dhe trajtoheshin pa ndonjë teprim nga ana e

rojtareve dhe ekzekutoreve të UÇK-së që zakonisht i godisnin robërit si të mundnin e ku të mundnin.

158. Çdo rob do ketë ndenjor në të paktën dy qendra ruajtjeje tranzitore apo kampe “etapash”, para se t’i dorëzohej klinikës që kryente operacionin. Këto kampe “etapash”, me sa duket të kontrolluara nga veprimtarë e ndihmës së UÇK-së të afërt me “Grupin e Drenicës” do jenë ngritur konkretisht në vendruajtjet e mëposhtme:

- Bicaj (rrethina e): shtëpi që i përket me sa duket një pronari privat dhe vendosur në një fshat të vogël në jug të Bicajt, në fushë të hapët, pranë rrugës kryesore të Peshkopisë;
- Burrel: një tërësi e vendosur në periferi të qytetit të Burrelit dhe përbërë të paktën nga dy struktura të veçanta, në të cilat mbylleshin robërit, si dhe një shtëpi ku mblidheshin e çlodheshin veprimtarët;
- Rripe: shtëpi autonome me dy kate e një ferme bujqësore, e quajtur shtëpia K. apo “shtëpia e verdhë”, që ka qenë objekt i një vizite mediko-legale të përbashkët të UNMIK-ut dhe GJPNIJ-së më 2004, pasi ka qenë identifikuar më parë nga gazetarët investigues;
- Fushë-Krujë: shtëpi tjetër autonome me dy kate, që bën pjesë në një fermë bujqësore dhe që ndodhet e shmangur nga rrugëkalimet e mëdha, në qendër të një kompleksi të gjerë, që do ketë shërbyer si “strehë” qoftë për përkrahësit e UÇK-së, qoftë për grupet e tjera të kriminelëve të organizuar që bënin trafik droge dhe trafikim të qenieve njerëzore.

3.3.2.2.1. Karakteri i qendrave të burgimit: Fushë-Krujë

159. Në këtë vendndodhje të fundit, zbuluar gjatë anketimit tonë, në Fushë-Krujë, do jetë përfunduar procesi i “shoshitjes” dhe do ketë gjetur vdekjen grupi i vogël i robërve të përzgjedhur nga UÇK-ja.

160. Shumë elementë të qëndrueshëm që kemi mbledhur pranë dëshmitarëve të drejtpërdrejtë, të bëjnë të mendosh se gjatë kalimit të tyre transit në pika të ndryshme të përkohshme, disa robër të paktën ishin ndërgjegjësuar për fatin që i priste. Në qendrat e ruajtjes ku ndodheshin e ku mund të dëgjoheshin nga persona të tjerë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe gjatë transportimit të tyre, disa nga këta robër u janë lutur gardianëve të tyre që të paktën të mos “i prisnin copa-copa”⁴⁵.

161. Robërit duhet të jenë vënë në dijeni shumë-shumë kur u merrej gjak me anë shiringe për kryerjen e testeve (një masë që duket se i ngjan “testeve të përputhshmërisë imunologjike” apo përcaktimit të niveleve të përputhshmërisë së transplantimit të organeve), apo kur ekzaminoheshin fizikisht nga njerëz të cilësuar “mjekë” se po trajtoheshin si një lloj produkti mjekësor. Sipas dëshmisë nga burime të drejtpërdrejta, këto teste dhe ekzaminime ishin zbatuar si në Rripe ashtu dhe në Fushë-Krujë.

⁴⁵ Do doja të theksoja, për të qenë sa më objektiv, se disa burime e kanë përmendur këtë frikë që ndienin robërit duke i dramaturgizuar faktet së tepërmi. Për shembull, nuk kemi gjetur asnjë element që të mbështesë pohimin sipas të cilit disa viktimave u ishte hequr njëra veshkë, më pas ishin “riqepur” dhe përsëri mbajtur në ruajtje para se t’u hiqej edhe veshka e dytë.

162. Dëshmitë mbi të cilat mbështeten konkluzionet tona përmendin në mënyrë të besueshme e koherente metodologjinë e ndjekur për vrasjen e të gjithë robërve, përgjithësisht me plumb në kokë, para se të operoheshin për t'u marrë një a më shumë organe. Mësuam se bëhej fjalë kryesisht për tregti “veshkash të marra nga kufoma”, domethënë për marrje veshkash pas vdekjes, dhe jo për një seri procedurash kirurgjikale të sofistikuara që do të kërkonin kushte klinike të kontrolluara dhe, për shembull, përdorim intensiv anestezikësh.

163. Burime të pavarura e të veçanta, të brendshme të UÇK-së, na komunikuan një numër elementesh e këndvështrimesh rreth funksionimit të rrjetit të trafikimit të organeve: nga njëra anë, këndvështrimi fokusuar drejt shoferëve, truprojeve e të tjerë “ndihmësve të vegjël” ngarkuar me detyra logjistike e praktike për dorëzimin e trupave në klinikë; nga ana tjetër, këndvështrimi fokusuar drejt “organizatorëve” dhe drejtuesve të rrjeteve kriminale që do kenë lidhur marrëveshje tregtare për furnizim organesh njerëzore për qëllime transplantimi në këmbim të shpërblimeve financiare të majme.

164. Pamja konkrete e këtij trafiku ishte relativisht e thjeshtë. Robërit e përcjellë gjer në Fushë-Krujë (gjë qo do të thotë shumë orë udhëtimi të vështirë nga Rripe në Burrel), fillimisht mbaheshin në “shtëpi strehimi”. I zoti i kësaj shtëpie, me etni shqiptare, do ketë mbajtur sa lidhje klanore aq dhe marrëdhënie kriminaliteti të organizuar me anëtarët e “Grupit të Drenicës”.⁴⁶

165. Kur konfirmohej se kirurgët e ngarkuar për transplantimin ishin në vend, të gatshëm për të operuar, robërit duhet të jenë nxjerrë një nga një jashtë “strehimit”, ekzekutoheshin shpejt e shpejt me plumb nga një veprimtar i UÇK-së dhe trupat e tyre transportoheshin menjëherë në klinikën ku kryhej operacioni.

166. Procedura kirurgjikale e zbatuar – nxjerrje veshkash nga një kufomë, në vend të një heqjeje kirurgjikale mbi një dhurues të gjallë – është mjeti më i rëndomtë për të shtënë në dorë organe e inde për qëllime transplantimi, pa folur këtu për anën kriminale të marrjes së tyre nga kufomat. Sipas ekspertësh të shquar në transplantime organesh që konsultuam gjatë hetimit tonë, kjo metodë është e efektshme dhe paraqet rreziqe të pakta.⁴⁷

167. Sipas burimeve, boshti Fushë-Krujë ishte zgjedhur për vendosjen e instalimeve për shkak të afërsisë së tij me aeroportin kryesor që i shërben Tiranës. Instalimet e kësaj platforme të rrjetit të trafikut të organeve – “strehimi” dhe klinika e përdorur për operacionet – paraqisnin rrjedhimisht lehtësi praktike si për pritjen e vizitorëve ndërkombëtarë ashtu dhe për të kryer ekspedimin e organeve.

4. Klinika Medicus

168. Gjatë hulumtimeve tona, u njohëm me të dhëna që shkojnë më larg – për nga përshkallëzimi e hollësitë – nga ato që kemi paraqitur në këtë raport. Ato duket që tregojnë praninë e një trafikimi të vërtetë ndërkombëtar kriminal të organeve njerëzore, ku përfshihen

⁴⁶ Bashkëpunimi i fshehtë i pronarit me rrjetet e shfrytëzimit seksual, të imigracionit ilegal në Europë e të kontrabandës, konkretisht për trafik droge e armë, çoi në arrestimin e tij nga forcat shqiptare të rendit; megjithatë, duket sikur nuk ka patur asnjë lidhje me krimet e kryera nga rrjeti i UÇK-së.

⁴⁷ Në të kundërt të skepticizmit të përgjithshëm rreth mundësisë se mund të jenë kryer operacione në Shqipëri në vitet 1999-2000 për të ushqyer trafikimin e organeve, ekspertët që ne konsultuam drejtpërdrejt e gjykuan përdorimin e kësaj metodologjie krejtësisht të mundshme, dhe kishin dijeni për veprimtari të përngjashme, po aq të paligjshme, në të cilat janë bërë heqje organesh mbi kufoma.

bashkëfajësi në të paktën tre vende të ndryshme të huaja (veç Kosovës), gjatë më shumë se një dhjetëvjeçari. Konkretisht, kemi mbledhur të dhëna të besueshme e konverguese që na çojnë në konkluzionin se trafiku i organeve që ka ndodhur pas mbarimit të konfliktit dhe që e paraqitëm në këtë raport, është në fakt i lidhur ngushtë me çështjen e sotme rreth klinikës “Medicus” me të paktën, pjesërisht, të njëjtët aktorë, si kosovarë dhe të huaj. Për të respektuar hetimin dhe procedurën gjyqësore në vazhdim drejtuar nga UELEX-i dhe Zyra e Prokurorit të posaçëm të Kosovës, ne hëpërhë, nuk po i bëjmë publike rezultatet e kërkimeve tona për këtë aspekt të veçantë. Megjithatë, na mbetet veç të nxisim fuqimisht tërë autoritetet e vendeve që kanë të bëjnë me çështjen “Medicus” të bashkëpunojnë plotësisht për të ndalur këtë veprimtari të turpshme dhe për të nxjerrë para drejtësisë përgjegjësit.

5. Tavanizimi i padukshëm i detyrimit për llogaridhënie

169. Kemi konstatuar se hetimet e sotme dhe vëniet tashmë nën akuzë që janë bërë nën kujdestarinë e Prokurorisë së posaçme të Kosovës vuajnë nga një “tavanizim i padukshëm” i detyrimit për llogaridhënie që bie mbi përgjegjësit e këtyre akteve.

170. Aksioni i ndërmarrë nga Prokuroria e posaçme e autoriteteve të Kosovës që drejtësia të jepet në emër të popullsisë kosovare, me sa duket po ndeshet në dy pengesa kryesore: Vështirësia e parë ka të bëjë me faktin se autoritetet e Kosovës administrojnë dhe kufizojnë me kujdes shtrirjen e hetimeve; bashkëpunimi i tyre me EULEX-in vuan kësisoj nga një mungesë e thellë besimi.⁴⁸

171. Së dyti, me sa duket, autorët e këtyre akteve do të parapëlqenin të dilnin para drejtësisë për rolin që mendohet se kanë luajtur përkatësisht në administrimin e kampeve të burgimit dhe në trafikimin e organeve njerëzore, sesa të kompromentonin ish komandantët e lartë të UÇK-së nën urdhrat e të cilëve ata do kenë vepruar dhe që sot janë bërë drejtues politikë e ekonomikë.

172. Para së gjithash, është zakoni i lashtë, me rrënjë ende të thella në disa shtresa të shoqërisë, i ndershmërisë së natyrshme ndaj klanit, apo ndaj ekuivalentit të tij në sferën e kriminalitetit të organizuar që, me sa duket, pengon Kosovarë të shumtë për të bërë të mundur që drejtësia të vihet me të vërtetë në vend. Edhe kur keqbërësit nuk janë pjesë e të njëjtit klan apo e një njëjtës familje të zgjeruar, besnikëria e tyre ndaj “kumbarës” së llumit është po aq e pathyeshme sa dhe lidhjet familjare.

⁴⁸ Hyrja e kufizuar e hetuesve të EULEX-it në bazat e të dhënave të krijuara në fushën e kriminalitetit nga homologët e tyre të Kosovës pasqyron këtë çështje të administrimit të informacionit. Drejtuesit lokalë u dhanë veprimtarëve të EULEX-it, pa kurrfarë dëshire nga ana e tyre, të drejtën për të hyrë në sistemin informatik të policisë së Kosovës (KPIS), por vetëm nëpërmjet një numri të caktuar emër-përdruesish e fjalë-kalimesh që duhej t’i bashkëngjiteshin procedurës ndërlihdëse të një oficeri të njohur e të përcaktuar nga EULEX-i. Kërkimet e bëra nëpër secilin prej këtyre emër-përdoruesve mund të mbikëqyreshin kështu drejtpërdrejt nga oficerët ndërlihdës të policisë së Kosovës, që e dinin kështu sistematikisht në cilin çast dhe në cilën frekuencë EULEX-i kishte kryer kërkime dhe për cilin person konkret. Kjo gjendje nuk i lejoi hetuesit e policisë së kohëve moderne t’i shpëtonin problemeve të rëndomta teknike, duke qenë se sistemi informatik KPIS rregullisht prishej. Edhe ekuivalenti i vet kushtuar targave të mjeteve, KVIS u arrit po ashtu të konsultohet nga hetuesit e EULEX-it, pas një periudhe bisedimesh me policinë e Kosovës, që shumë pak u tregua e gatshme për bashkëpunim. Por gjuha e kësaj baze të dhënash të vënë në dispozicion të tyre ishte vetëm në shqip, ndryshe nga prototipi fillestar i përpunuar bashkëngjitur nën autoritetin e UNMIK-ut. MMA (“Monitoring, Mentoring and Advising”), emblema treguese e lidhjeve midis EULEX-it dhe policisë kosovare, as që ka rëndësi kur partnerët kosovarë bëjnë tepër saktë atë që duan; veprimtarëve ndërlihdës ndërkombëtarë nuk u mbetet atëherë gjë tjetër veç të hartojnë një raport, që do ndjekë rrugën hierarkike dhe do përfundojë pa dyshim në ndonjë zyrë, diku në Bruksel, për t’u trajtuar me zellin më minimal, thjesht për respekt të rrethanave politike.

173. Pikërisht për këtë arsye, Sabit Geqi do të shmangë me kujdes të kompromentojë përgjegjësit e vërtetë – sot të shndërruar në personalitete publike të nderuara – lidhur me aktet e torturës të kryera ndaj robërve civilë në Kukës. Po ashtu, Ilir Rrecaj do të vazhdojë të pranojë t'i bien në kurriz pasojat e statutit të tij si dash kurban për aktet autorizuese e financuese të paligjshme të klinikës Medicus të Prishtinës, se sa të përcaktojë përgjegjësit e vërtetë të këtyre veprimeve kriminale të organizuara në Kosovë në sektorin e shëndetësisë.

174. E gjithë kjo ka për qëllim që t'u bëjë të mundur disa udhëheqësve politikë të shmangin në mënyrë të besueshme pohimet sipas të cilave UÇK-ja do ketë marrë pjesë në akte burgimi, torture dhe vrasje në Shqipëri, dhe t'i paraqesë si një "spektakël" i thjeshtë, orkestruar nga propaganda politike serbe, thënie serioze që meritojnë, siç e pamë, hetime shumë më të thella se ato që janë bërë gjër më sot.

6. Disa mendime përfunduese

175. Ky raport – le ta kujtojmë edhe një herë – mori shkas nga njoftimet e botuara në librin e ish Kryeprokurores së GJPNIJ-së. E tronditur nga këto zbulime, Asambleja parlamentare na besoi misionin për të kryer një shqyrtim më të thelluar lidhur me këto pohime e shkelje të të drejtave të njeriut që do jenë bërë gjatë periudhës në fjalë në Kosovë. Faktet e denoncuar në librin e ish Magjistres i referohen kryesisht një trafikui organesh njerëzore. Kërkimet tona, të vështira e delikate na lejuan jo vetëm të vërtetojmë këto pohime, por edhe të saktësojmë e të shfaqim një tablo të errët e shqetësuese për atë që ka ndodhur dhe, pjesërisht, vazhdon të ndodhë në Kosovë. Detyra jonë nuk ishte të bënim një hetim penal – nuk kemi për këtë as fuqinë e as, sidomos, mjetet – e aq më pak të jepnim gjykime dënimi apo fajësimi.

176. Faktet që kemi mbledhur janë megjithatë të një rëndësie të jashtëzakontë dhe kanë ndodhur në zemrën e Europës. Këshilli i Europës dhe shtetet e tij anëtare nuk mund të qëndrojnë indiferentë përballë një gjendjeje të tillë. Kemi vënë në dukje ekzistencën e një dukurie të rëndësishme kriminaliteti të organizuar në Kosovë. Është e vërtetë se nuk është një risi dhe nuk është një përjashtueshmëri e Kosovës. Në rajon, krimi i organizuar është shumë i tmerrshëm po ashtu edhe në Serbi, Mal të Zi, Shqipëri, për t'i marrë si shembull. Ekzistojnë nga ana tjetër lidhje dhe bashkëfajësi të habitshme e shqetësuese midis këtyre bandave të ndryshme. Bashkëpunimi i tyre duket për më tepër shumë më i efektshëm sesa midis autoriteteve gjyqësore kombëtare e ndërkombëtare. Vumë në dukje dhe dokumentuam lidhjet e turbullta, shpesh të dukshme, midis krimit të organizuar dhe politikës, përfshirë edhe përfaqësues të institucioneve; edhe kjo nuk është një risi, të paktën për ata që nuk kanë dashur kursesi të mbyllin sytë e veshët. Heshtja dhe mungesa e reagimeve përballë një skandali të tillë janë në fakt po aq të rënda dhe të papranueshme. Ne nuk u bëmë përhapës fjalësh të thjeshta lart e poshtë, por përshkruam fakte që mbështeten në dëshmi të shumta, në dokumente dhe fakte objektive. Ajo çka zbuluam nuk është krejt e pabotuar: raporte nga të rëndësishmit të shërbimeve informative e policisë kanë denoncuar tashmë dhe pasqyruar me hollësi po këto fakte që prej kohësh. Pa u dhënë vazhdimësi, sepse kancelaritë privilegjonin në çdo rast profilin e ulët, heshtjen, për të ashtuquajturat konsiderata "përshtatshmërie politike". Por ç'interesa mund të përligjin një qëndrim të tillë që përbuz krejt vlerat dhe që kurrë nuk mungohet të përmendet publikisht? Të gjithë janë në dijeni të asaj çka ndodhi në Kosovë, dhe të asaj çka ndodh edhe sot, por njerëzit nuk flasin, në mos në mënyrë intime; ata presin prej kohësh që e vërteta, krejt e vërteta – jo ajo zyrtarja – më në fund të vendoset. Ambicia jonë e vetme sot është të jemi zëdhënësit e atyre burrave e grave të Kosovës, por edhe të Serbisë e të Shqipërisë, pa dallim etnie apo feje, që nuk kanë veçse një aspiratë: që e

vërteta të dalë në shesh dhe që t'i jepet fund një mosndëshkimi skandaloz, dhe përfundimisht që të mund të jetojnë në paqe. Është një kusht i domosdoshëm për një ripajtim të vërtetë dhe për një stabilitet të qëndrueshëm në këtë rajon. Gjatë misionit tonë, kemi takuar persona – lokalë e ndërkombëtarë – me vlerë shumë të madhe që luftojnë kundër indiferentizmit dhe për një shoqëri më të drejtë. Ata nuk meritojnë vetëm simpatinë tonë, por gjithashtu e sidomos, mbështetjen tonë të plotë.

Shtojcë

Qendra burgimi në Shqipëri të përdorura nga anëtarët e UÇK-së dhe ndihmësit e tyre për qëllime trajtimi çnjerëzor dhe trafikimi të paligjshëm organesh njerëzore

Asambleja parlamentare
Komisioni i çështjeve juridike dhe të drejtave të njeriut
Raporter : Dick Marty, Zvicër, ADLE

BURGIME NGA UÇK NË KOHË LUFTE

Në këto vende “robërit e luftës” janë mbajtur në ruajtje, janë pyetur dhe trajtuar në mënyrë çnjerëzore, gjer në fund të luftës së Kosovës në qershor 1999 (shih pjesën 3.3.1. të raportit).

BURGIME PAS MBARIMIT TË KONFLIKTIT

Nga korriku 1999 në gjysmën e 2000, “të zhdukur” mjaft të shumtë janë ruajtur në një rrjet ad hoc përqendrimesh. Të gjithë do jenë vlarë. Një grusht prej tyre kanë qenë “viktima të kriminalitetit të organizuar”, duke qenë se u janë hequr veshkat për t'u përdorur nga një rrjet ndërkombëtar trafiku organesh (shih pjesën 3.3.2. të raportit).

LËVIZJE ROBËRISH

Robërit e rrëmbyer në Kosovë dërgoheshin në anën tjetër të kufirit poroz. Pas një “shoshitjeje” të njëpasnjëshme dhe gjithnjë e më shumë përzgjedhëse, bazuar konkretisht në origjinën etnike dhe gjendjen shëndetësore, robërit përcilleshin në një vend tjetër. Disa kanë

kaluar nga shumë kampe “etapash” para se të dorëzoheshin përfundimisht në klinikën që kryente operacionin.

* Çdo referim për Kosovën përmendur në këtë tekst, qoftë territori, institucionet apo popullsia, duhet kuptuar në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykuar statusin e Kosovës.

Konceptimi grafik nga Once Were Farmers